

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2017



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1001
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 4 2258046
Faqja e internetit: www.erru.al

©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Qershor 2018

Përmbajtja

Shkurtime	2
Përmbledhje	3
Hyrje	9
Reforma në Sektor	11
1. Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	13
1.1 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave	13
1.2 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	13
1.2.1 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe Mbulimi me Shërbimet e KUN	14
1.2.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe Mbulimi i Kostos Totale	14
1.2.3 Norma e Arkëtimit	17
1.2.4 Efienca e Stafit	18
1.2.5 Uji Pa të Ardhura (UPA)	19
1.2.6 Niveli i Matjes	20
1.2.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	20
1.3 Rezultatet Financiare të Sektorit	21
1.3.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet	21
1.3.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK	22
1.4 Agregimi	23
2. Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetës Kanalizime	25
2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK	25
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	27
2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës	28
2.3.1 Uji Pa të Ardhura	28
2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M	33
2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale	39
2.3.4 Norma e Arkëtimit	44
2.3.5 Niveli i Matjes	50
2.3.6 Efienca e Stafit	56
2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	61
2.3.8 Mbulimi me Kanalizime	68
3. Konkluzione	73
4. Aneke: Të dhënat Kryesore të Përzgjedhura	75

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUK	Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korente
RAT	Reforma Administrative Territoriale

Përmbledhje

Raporti i Performancës si instrument analize, informimi dhe transparence në kuadër të reformës në sektorin e UK

Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri të licencuar në këtë sektor përbën një detyrim ligjor të ERRU-së si organ i pavarur.

Raporti i Performancës së shoqërive UK për vitin 2017 hartuar nga ERRU merr një rendësi të veçantë në kuadër të reformës në sektorin e ujit që ndërmori Qeveria në fund të muajit Tetor të 2017. Informacioni, analiza dhe konkluzionet që përcjell ky raport shërbejnë jo vetëm si një mekanizëm transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve që përfshihen në të, por jep edhe një analizë përgjithësuese për të gjithë sektorin përfshirë dhe rekomandimet përkatëse për problematikat që kërkojnë zgjidhje për arritjen e objektivave të saj.

Në detaje analizohet performanca e sektorit të UK, veçoritë e tij në fazën e riorganizimit, shkaqet e performancës së dobët të shoqërive, si dhe jepen rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko ekonomike të tyre.

Raporti publikohet në faqen e web-it të ERRU-së në mënyrë që veçanërisht konsumatorët të informohen dhe që ato të rrisin kërkesën e llogarisë ndaj shoqërive UK për ofrimin e shërbimeve me tarifa të justifikuara dhe me cilësinë e duhur.

Reforma e Qeverisë Qendrore në Sektorin UK

Viti 2017 ka qenë viti i vazhdimësisë së zbatimit të reformës në sektorin e UK iniciuar në zbatim të VKM Nr. 63, datë 27.01.2016. Sektori duhej të riorganizohej në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale sipas parimit një bashki një shoqëri UK, proces i cili duhej të ishte mbyllur deri në fund të vitit 2016. Duke pasur parasysh përfshirjen e sistemeve rurale në zonën e shërbimit të UK, riorganizimi i sektorit rezultoi mjaft i vështirë dhe rezultatet e pritshme për përmirësimin e performancës së sektorit nuk u arritën. Deri në fund të viti 2017 nga 58 shoqëri UK vetëm 25 prej tyre arritën të përfundonin procesin e riorganizimit në përputhje me VKM Nr. 63. Sektori UK vazhdoi të karakterizohej nga një performancë mjaft e dobët, për rrjedhojë Qeveria në fund të viti 2017 ri-lançoi reformën duke pasur parasysh zbatimin e masave emergjente me objektivat që duhet të realizohen deri në fund të vitit 2018. Masat emergjente synonin që brenda një afati tre mujor të realizohej legalizimi i lidhjeve të paligjshme me atë të vetdeklarimit vullnetar të konsumatorëve që i dispononin këto lidhje. Paraprakisht vlerësohej që lidhjet e paligjshme përbënin rreth 20% të konsumatorëve në zonën e shërbimit. Mbas këtij afati do të fillonte faza e ndëshkimit sipas ligjit e abuzuesve dhe mospaguesve të faturave të shërbimeve të UK. Për nxitjen dhe matjen e performancës së shoqërive, reforma gjithashtu parashikonte dhe lidhjen e marrëveshjeve të performancës ndërmjet Bashkive dhe MIE (AKUK) me tregues performance të matshëm, proces i cili do të realizohet në muajt e parë të vitit 2018.

Shoqëritë UK në proces riorganizimi

Të dhënat për vlerësimin e performancës së sektorit janë bazuar në raportimet e të gjitha shoqërive UK pranë AKUK për vitin 2017. Për mjaft shoqëri UK, është e vështirë që të gjykohej performanca dhe tendenca e saj (benchmarking) krahasuar me një vit më parë, sepse gjatë vitit 2017 ato kanë qenë akoma në proces ose nuk kanë përfunduar procedurat e riorganizimit në përputhje me reformën.

Në këto raste raportohen të dhëna dhe tregues performance për zonën e re të shërbimit, por pa një bazë krahasimi me vitin e mëparshëm.

Zonat e reja rurale dhe influenca në performancën e shoqërive UK të riorganizuara

Zonat e reja rurale të përfshira në zonat e reja të shërbimit të shoqërive UK përbëjnë një barrë shtesë financiare meqenëse ato përfaqësojnë shpenzime operimi shtesë dhe njëkohësisht të ardhura më të vogla nga konsumatorët për shkak të tarifave mjaft të ulëta që aplikoheshin më parë në këto zona, si edhe nga shkalla e ulët e nivelit të arkëtimit. Ky realitet duhet të konsiderohet nga Qeveria Qendrore për mbështetje shtesë financiare të shoqërive UK.

Shoqëritë e vogla UK kanë mungesë të kapaciteteve

Bashkitë dhe shoqëritë UK relativisht të vogla dhe në zona të largëta hasin mjaft vështirësi për sigurimin e personelit me kualifikimin e duhur në përputhje me kërkesat që legjislacioni parashikon për pozicionet e stafit manaxhues të shoqërive.

Shoqëritë UK duhet të pajisen me një Plan Biznesi 5 Vjeçar

Shoqëritë e riorganizuara duhet të shohin si prioritet hartimin e një Plani Biznesi 5 vjeçar me planet e veprimit përkatëse për përmirësimin e treguesve të performancës, ku përfshihet veçanërisht një program investimesh fizike, programi i lidhjeve të paligjshme, program i instalimit të ujëmatësve, përmirësimit të normës së arkëtimit etj.

Performanca e Sektorit UK

Performanca e sektorit të UK jepet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 1 bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës që ERRU përdor për të vlerësuar performancën e shoqërive UK.

Tabela 1. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK

Treguesit e Performancës	2016	2017	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
Uji Pa të Ardhura (%)	67.1	65	↗	30
Mbulimi i Kostove O&M (%)	117.9	109	↘	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	89.8	85	↘	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	91.03	92.76	↗	82
Norma e Arkëtimit Korente(%)	78.48	78.84	↗	82
Niveli i Matjes (%)	64.6	68.3	↗	85
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.34	5.50	↘	4/6/10
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	12.3	12	↘	18
Mbulimi me Kanalizime UN (%)	50.7	50.2	↘	75
Mbulimi me F. me Ujë (%)	79.4	78.3	↘	n/a

Burim informacioni: AKUK

Besueshmëria dhe Saktësia e të dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK

Të dhënat për analizën e performancës së shoqërive UK dhe të sektorit në përgjithësi merren nga AKUK, si edhe nga bilanci financiar për vitin 2017 që shoqëritë kanë dorëzuar pranë ERRU. Në mjaft raste vërehet dukshëm që të dhënat përmbajnë pasaktësira të konsiderueshme. Ky fakt reflektohet veçanërisht në bilanci të ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilat hartohen në mënyrë empirike dhe sipërfaqësore për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Si pasojë treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura, rezulton me nivel të lartë pasaktësie. Hartuesit e Raportit kanë bërë

përpyjekjet maksimale në analizën e të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij pjesën e të dhënave që nuk kanë një bazë justifikimi në lidhje me vërtetësinë e tyre për të eliminuar vlerësimet e gabuara të performancës së sektorit në përgjithësi, si dhe të secilës shoqëri në veçanti.

Konstatimi vlen edhe për të dhëna të tjera, si për gjendjen e aseteve, inventarin, numrin e difekteve në total, apo për km tubacion etj, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të tjerë që lidhen me vlerësimin e performancës së shoqërisë.

***Sektori në gjendje
performance të
pakënaqshme***

Treguesit e Performancës së Sektorit të UK për vitin 2017 tregojnë për një tendencë përqendrimi të gjendjes së tij. Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë (mesatarisht 12 orë/ditë), si dhe treguesi i Ujit Pa të Ardhura (65%) krahasuar me vitin 2016 mbeten në vlera të papranueshme. Norma e Arkëtimit korente (78.84% nga 78.48%) ka një përmirësim të lehte, ndërsa treguesit e performancës financiare të mbulimit të kostove të O&M e ato totale janë përqesuar në vlerën rreth 10%.

Paraqitet shqetësues sidomos treguesi i Ujit Pa të Ardhura që vazhdon të jetë në nivele të papranueshme (65%). Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë jo vetëm nuk gjeneron të ardhura, por rrit edhe kostot e shërbimit të furnizimit nga faktori i konsumit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër përmirësimi i këtij treguesi lidhet mjaft me treguesin e cilësisë së shërbimit vlera e ulët e të cilit sjell si pasojë orar të reduktuar të kohës së FU dhe ulje të presionit në tubacione. Gjithsesi përmirësimi me 2% i UPA duhet marrë me rezervë sepse vlerësimi i tij ka doza të konsiderueshme pasaktësie të dhënash të raportuara nga shoqëritë UK.

***Gjendja
financiare e
Sektorit UK***

Gjendja financiare e sektorit gjatë vitit 2017 është përqesuar në krahasim me vitin 2016. Në total defikiti i mbulimit të kostove të O&M me të ardhurat për sektorin është rreth 1,250 milion Lekë (rreth 10 milion euro), nga të cilat rreth 38% të kësaj vlere e përbën defikiti i shoqërive UK Durrës dhe UK Vlorë, ndërsa 85% e totalit i përket vetëm 13 shoqërive UK nga 58 që është numri total i tyre. Vlerësohet se 37 shoqëri nga 58 vazhdojnë të subvencionohen nga buxheti i shtetit. Qeveria qendrore ka shpërndarë në total për sektorin 1,039 milion lekë (rreth 8 milion euro).

Ndërkohë defikiti për mbulimin e kostove totale është sa dyfishi i vlerës së defikutit të mbulimit të kostove të O&M.

Kjo gjendje argumentohet me rritjen e kostove operative, kryesisht me rritjen e numrit të fuqisë punëtore dhe të konsumit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër rritja e të ardhurave në vlerë absolute (në përqindje është ulur) ka ardhur kryesisht nga rritja e tarifave të shërbimit në disa shoqëri gjatë vitit 2017. Ky rezultat financiar do të ishte akoma më negativ nëse në sajë të ndikimit të reformës shoqëritë nuk do të kishin arritur një performancë mjaft të mirë për mbledhjen e debive të vjetra, që e ka rritur treguesin e Normës së Arkëtimit të Përgjithshme në nivelin 92.76%, por që në fakt Norma e Arkëtimit pa debitë është 78.84%, pra rreth 0.36% më e lartë se viti 2016.

Shoqëritë UK janë të mbingarkuara me staf

Pagat e punonjësve së bashku me energjinë elektrike janë dy elementet kryesorë të kostove të operimit të shoqërive UK. Treguesi i performancës së Eficencës së Stafit (mesatarisht 5,5 staf/1000 lidhje) është përkeqësuar dhe në përgjithësi sektori paraqitet i mbingarkuar me staf. Shoqëritë UK edhe gjatë vitit 2017 vazhduan të shtojnë numrin e punonjësve në mënyrë të pajustificuar. Krahës marrjes në punë të një personeli mbi nevojat reale për operimin e shoqërive UK, këtë tregues e rëndon edhe numri i madh i punonjësve shtesë si roje objektsh për operimin e depove të ujit, si edhe të puseve dhe stacioneve të pompimit. Në fakt kjo është një kërkesë ligjore për garantimin e sigurisë ndaj shëndetit publik, por ky element mund të rikonsiderohet nga ana ligjore, sepse garancia e sigurisë publike për këto objekte mund të realizohet edhe me masa teknike dhe logjistike.

Sektori është mjaft i fragmentarizuar

Sektori vazhdon të jetë mjaft i fragmentarizuar me rreth 60 shoqëri UK, ku vetëm shoqëritë e mëdha si UK Tirana dhe UK Durrës mbulojnë rreth gjysmën e popullsisë rezidente (Censusi i vitit 2011). Kuptohet që perspektiva e afërt dhe afatmesme për rritjen e performancës financiare të shoqërive të mesme dhe të vogla është agregimi (shkrirja) i tyre në shoqëri më të mëdha për të rritur efektin e ekonomisë së shkallës. Agregimi duhet të realizohet me baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore.

KONKLUZIONE

Reforma në Sektorin UK

- Ndihet nevoja e përsheptimit të reformës në sektor. Për këtë kërkohet një angazhim më i madh i bashkive dhe shoqërive UK për regjistrimin e tyre si shoqëri të riorganizuar në përputhje me reformën, si edhe të institucioneve të tjera që kanë lidhje me sektorin duke vendosur afate dhe klauzola që parashikojnë sanksione në rast mosrespektimi të tyre.
- Në kuadër të aksionit të qeverisë janë evidentuar 14,366 lidhje të reja (Tetor 2017-Maj 2018, të konsideruara si lidhje të paligjshme), të cilat përfaqësojnë vetëm 1.7% të numrit të përgjithshëm të konsumatorëve, prandaj është e nevojshme të rishikohet plani i masave për reformën në sektor për arritjen e objektivave të vendosura për vitin 2018 dhe atij afatmesëm ku pritshmëria për lidhjet e paligjshme ka qenë në vlerën e 20% të numrit të përgjithshëm të konsumatorëve.
- Duke pasur parasysh defiçitin financiar të operimit të sektorit UK dhe nevojës për subvencione, ku 67% e totalit të nevojës për to i përket shoqërive, Durrës (23%), Vlorë (15%), Patos (14%), Lushnjë (5%), Kavajë (4.5%) dhe Kurbin (4.5%). Prandaj, për shëndoshjen financiare të sektorit, duhet të riorientohet fokusi i reformës për fazën emergjente në realizimin e një analize më të thelluar të performancës së shoqërive të mësipërme për të përcaktuar shkaqet e performancës së dobët financiare, si dhe hartimi i Plan Veprimeve për përmirësimin e saj.

- Aktorët vendorë dhe qendrorë të sektorit të UK të intensifikojnë punën për ndërgjegjësimin e popullsisë për reformën në sektorin UK me anë të mediave kryesisht vizive në emisione të organizuara posaçërisht për këtë qëllim, si edhe të zbatohet me rigorozitet ligji në lidhje me kundërvajtësit dhe abuzuesit, dhe për rritjen e Normës së Arkëtimit.
- AKUK në bashkëpunim me ERRU-në të rishikojë formën e Kontratave të Performancës ndërmjet Bashkive dhe MIE (AKUK) për përcaktimin e Treguesve të Performancës bazë të këtyre kontratave, të peshës së secilit tregues rast pas rasti. Rivlerësimi i shkallës së realizimit të Treguesve të bëhet nga ERRU, si institucion i pavarur dhe pa konflikt interesi kundrejt dy palëve të kontratës.
- Të përmirësohet mekanizmi i vlerësimit-planifikim-alokim fondesh nga qeveria qendrore nëpërmjet MIE (AKUK) për një periudhë tranzicioni që shoqëritë e riorganizuara UK të mund të përballojnë kostot shtesë nga rritja e zonës së tyre të shërbimit me sistemet e FU që administroheshin më parë nga ish komunitat.

AKUK dhe ERRU

- Të forcohet procesi i monitorimit të fondeve të investimeve publike nga qeveria qendrore dhe donatorët.
- Administrimi dhe verifikimi i të dhënave do të jetë më efikas nëse do të realizohet direkt nga ERRU (jo nëpërmjet AKUK) sepse ERRU i ka kapacitetet dhe autoritetin ndaj shoqërive UK për të rritur përgjegjshmërinë e shoqërive UK për raportimin e të dhënave tekniko-ekonomike të sakta.
- Të vlerësohen nevojat për të pajisur të gjithë sistemet e furnizimit me ujë në sektor me ujëmatës të mëdhenj që mundësojnë hartimin e balanceve të sakta të ujit dhe të kërkesës për ujë, si dhe planifikimin e fondeve që qeveria qendrore duhet të kontribuojë për shoqëritë që nuk kanë mundësi financiare për prokurimin e tyre.
- ERRU rekomandohet të përfshihet në procesin e përcaktimit të prioritetëve të investimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, si dhe në aprovimin e tyre bazuar në kriteret tekniko ekonomike.
- ERRU do të forcojë kërkesat ndaj shoqërive për të argumentuar numrin e stafit dhe pozicionet e tyre si pjesë e kostove të operimit të tyre që influencon në vlerat e tarifave që ato propozojnë për konsumatorët.
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi i tyre si një prerogativë ligjore kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja. AKUK të vlerësojë nevojat dhe të incetivojë financimin e hartimit të tyre nga qeveria qendrore për shoqëritë që kanë mundësi financiare të kufizuara.

- Të ndiqet një politikë e rishikimit të tarifave në drejtim të përballueshmërisë nga konsumatorët për të vlerësuar kapacitetet reale financiare të shoqërive UK për mbulimin e kostove të O&M dhe të veçohen ato shoqëri që shëndoshja financiare e tyre kërkon tarifa mjaft të larta të papërballueshme për konsumatorët që duhet të subvencionohen nga qeveria qendrore apo lokale.
- Roli monitorues i performancës së shoqërive UK duhet të përqendrohet kryesisht tek ERRU.
- Rishikimi i legjislacionit për plotësimin e kërkesave ndaj stafit kyç të shoqërive UK që të jenë të diferencuara për shoqëritë e mëdha, të mesme dhe të vogla.
- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve.
- Sektori paraqitet mjaft i fragmentarizuar prandaj ndihet e nevojshme që qeveria qendrore të shoh si prioritet të afërt fillimin e realizimit të strategjisë së agregimit të shoqërive me një ose dy projekte pilot, aty ku shihet më i mundshëm suksesi, duke respektuar kriteret e vullnetit të lirë të pronarëve si dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Strategjia e agregimit të sektorit duhet të orientohet kryesisht në grupin e shoqërive të dimensionit të mesëm, rast pas rasti dhe jo në bllok.

***Për Investimet në
Nivelin Strategjik
dhe Agregimi***

Hyrje

Enti Rregullator i Ujit është një institucion publik i pavarur, përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar. Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri të licencuar në këtë sektor përbën një detyrim ligjor të ERRU-së. ERRU si institucion i pavarur ka për detyrë që të jetë sa më objektiv në vlerësimet e tij për sektorin e UK, pjesë e rëndësishme e të cilit është hartimi i Raportit Vjetor 2017 të Performancës të Sektorit UK.

Raporti i Performancës së shoqërive UK 2017 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës të të gjithë sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Raporti analizon shkaqet e performancës së dobët të sektorit UK dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko ekonomike të performancës së shoqërive. Nga ana tjetër, shoqëritë UK e shohin raportin si një mjet për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera në sektorin UK.

Raporti bazohet në të dhënat teknike ekonomike vjetore të 2017 të operimit të shoqërive UK që raportohen në AKUK në Njësinë e Monitorimit dhe Benchmarking. Të dhënat në aspektin kohor merren pas tremujorit të parë të vitit dhe janë të disponueshme për ERRU normalisht brenda muajit Maj 2018. Duke parë rëndësinë e analizës, konkluzioneve dhe sidomos të rekomandimeve që jepen në Raport për përmirësimin e performancës së Sektorit UK, ERRU ka bërë përpjekjet maksimale që raporti të jetë i publikuar deri në fund të Qershorit 2018.

Sektori UK gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin 2016 vazhdoi të karakterizohej nga një performance mjaft e dobët dhe me një tendencë të lehtë përkeqësimi. Përveçse një përmirësimi të lehtë të treguesit Uji Pa të Ardhura të gjithë treguesit e tjerë të performancës së sektorit kanë pësuar rënie. Përgjithësisht viti 2017 (deri në tremujorin e fundit të tij) ka pasur një angazhim jo në nivelin e duhur për zbatimin e reformës së sektorit UK që qeveria ndërmori në fillim të vitit 2016. Përkeqësimi i treguesve të performancës së sektorit vërehet, si për shoqëritë që kanë përfunduar riorganizimin me zonat rurale që më parë administroheshin nga vetë ish Komunat, edhe për ato shoqëri që akoma nuk e kanë përfunduar atë, por që realisht i ofrojnë dhe administrojnë shërbimet UK edhe në këto zona.

Zonat e reja rurale të përfshira në zonat e reja të shërbimit të shoqërive UK përbëjnë një barrë financiare shtesë për këto të fundit. Zonat rurale nga reforma transferohen në shoqëritë UK me balance negative sepse shpenzimet e operimit ato i kanë pasur të pambuluara nga të ardhurat për shkak të tarifave mjaft të ulta që aplikoheshin më parë në këto zona, si edhe nga shkalla e ulët e nivelit të arkëtimit.

Të gjitha problematikat e akumuluar në të shkuarën në sektor diktuan nevojën urgjente që reforma në sektor të rikonsiderohej në baza të tjera më realiste dhe efektive, iniciativë që qeveria ndërmori në fund të vitit 2017. Reforma përfshinte ndër të tjera zbatimin e masave emergjente brenda një afati tremujor kryesisht në eliminimin e lidhjeve të paligjshme, si dhe objektiva që duhet të realizohen deri në fund të vitit 2018.

Gjithsesi shoqëritë UK të riorganizuar kanë nevojë urgjente që të hartojnë një Plan Biznesi 5 Vjeçar për të bërë një skanim të situatës dhe performancës së tyre, të problematikave në menaxhim dhe nevojave për investime. Këto plane do të shërbejnë si udhërrëfyes për të arritur objektivat e vendosura për t'u realizuar me anë të planeve të veprimit të detajuara dhe realiste.

Planet e biznesit, planet e menaxhimit të aseteve, programet e lidhjeve ilegale janë disa nga instrumentet orientuese kryesore për shëndoshjen e gjendjes financiare të shoqërive UK dhe për të përcaktuar nevojat për investime fizike. Pajisja me Plane Biznesi 5 Vjeçare të shoqërive UK duhet të konsiderohet si domosdoshmëri apo prerogative ligjore, jo vetëm si instrument për mirëmenaxhimin e shoqërive, por edhe si argument kryesor justifikues kur ato aplikojnë për tarifa të reja tek ERRU-ja.

Zbatimi i reformës në sektorin UK ka një shembull mjaft pozitiv shoqërinë UK Korçë, e cila i ka zgjidhur me sukses të gjitha vështirësitë e përfshirjes në zonën e shërbimit të zonave të reja rurale të prapambetura. Kjo shoqëri ka zbatuar me sukses regjistrimin e të gjithë aseteve shtesë me prejardhje nga zonat rurale, ka realizuar me fondet e veta investime emergjente në mjaft fshatra dhe i ka integruar ato në sistemet e menaxhimit tekniko financiar të shoqërisë.

Si konkluzion, përmirësimi i performancës për të gjithë sektorin në tërësi duhet të lidhet ngushtësisht me një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve të këtij sektori, përkatësisht shoqërisë UK, bashkisë dhe qeverisë qendrore.

Reforma në Sektor

Qeveria ndërmori fillimisht reformën në Janar 2016 në sektorin e ujit me VKM nr. 63, datë 27.01.2016. Shtysa kryesore për reformën ishte performanca mjaft e dobët e sektorit gjatë gjithë fazës së tranzicionit si në aspektin financiar edhe atë të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Sektori UK mbetej një barrë e rëndë financiare për buxhetin për financimin e shpenzimeve të O&M, pa përmendur nevojat për investime fizike. Kërkesa për reformë u bë më e domosdoshme edhe në kuadrin e Reformës Administrative Territoriale duke zvogëluar në 61 bashki organizimin administrativ të vendit duke eliminuar të gjitha komunat e mëparshme. Reforma në Sektorin UK presupozonte riorganizimin e sektorit UK sipas parimit 1 bashki - 1 shoqëri, i cili duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2016. Reforma parashikonte gjithashtu përfshirjen direkte të Kryebashkiakëve në përgjegjësinë dhe manaxhimin e shoqërive UK, si dhe parashikoheshin nga ana ligjore ngritja e kapaciteteve të stafeve manaxhuese të shoqërive. Reforma paraqiti mjaft vështirësi në riorganizimin burokratik të shoqërive, si dhe në përmbushje të kërkesave të kapaciteteve të stafeve të shoqërive. Si rrjedhojë deri në fund të vitit 2017, vetëm 25 shoqëri UK kishin përfunduar riorganizimin e tyre dhe gjendja e sektorit nuk u përmirësua.

Për zgjidhjen e problematikës së përmirësimit të gjendjes së shërbimeve UK, qeveria qendrore ri-lançoi reformën në sektorin UK në fund të Tetorit 2017. Reforma konsistonte në ndërhyrje përgjatë një faze emergjente (tremujore) kryesisht në eliminimin e lidhjeve të paligjshme në sistemet e furnizimit me ujë duke i legalizuar ato bazuar në vetdeklarim dhe pa konsekuenca ligjore. Më tej konstatimi i lidhjeve të paligjshme do të shoqërohej me penalitetet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlerësimi paraprak për pritshmërinë e pranisë së tyre në sistemet e furnizimit me ujë ishte për rreth 20% e konsumatorëve.

Aspekti me rëndësishëm i reformës konsistoi gjithashtu që në fillim të vitit 2018 secila Bashki (shoqëri UK) duhej të nënshkruante Kontratën e Performancës me AKUK në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për një periudhë njëvjeçare bazuar në tregues performance. Kontrata shoqërohet me incentiva si subvencione që duhet të përftonin shoqëritë UK, dhe/ose investime fizike për performancën e arritur. Duke pasur parasysh urgjencën për lidhjen e kësaj kontrate, ishte e pamundur që të mund të vlerësoheshin dhe përcaktoheshin saktë tregues performance për secilën shoqëri UK si objektiva për t'u arritur në fund të vitit 2018 krahasuar me treguesit aktual të performancës. Vlerësimi përfundimtar i tyre krahasuar me pritshmërinë do të behej për secilën kontratë në fund të vitit.

Megjithëse raporti merr në konsideratë analizën dhe performancën e sektorit për vitin 2017, në kuadër të reformës është mjaft e rëndësishme të përmenden rezultatet për eliminimin e lidhjeve të paligjshme me pritshmërinë e tyre. Aktualisht në rang vendi janë raportuar nga shoqëritë në total legalizim i 6525 lidhjeve të paligjshme.

Duke pasur parasysh pritshmërinë e rezultateve për rritjen e numrit të klientëve dhe përmirësimin financiar të gjendjes së shoqërive, orientimi i reformës pas fazës emergjente duhet drejtuar tek të shëndoshja financiare e shoqërive UK që përbëjnë bazën e deficitit financiar në operimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Analiza e performancës financiare nxjerr në pah nevojën për të bërë një analizë të thelluar të shkaqeve të performancës së dobët, përkatësisht shoqëritë, UK Durrës, UK Vlorë, UK Patos, UK Lushnje, UK Kavajë dhe UK Kurbin, që kërkojnë rreth 67% të nevojave për subvencione në sektor. Natyrisht plani i masave duhet të vazhdojë gjithashtu në të njëjtat drejtime sikurse përcaktohet në dokumentin e reformës së sektorit të ujit. Veçanërisht është e rëndësishme përqëndrimi i fokusit në hartimin dhe

monitorimin e saktë të kontratave të performancës ndërmjet AKUK dhe Bashkive.

AKUK në bashkëpunim me ERRU-në duhet të rishikojë formën e Kontratave të Performancës ndërmjet Bashkive dhe MIE (AKUK) për përcaktimin e Treguesve të Performancës bazë të këtyre kontratave, të peshës së secilit tregues rast pas rasti. Rivlerësimi i shkallës së realizimit të treguesve të bëhet nga ERRU, si institucion i pavarur dhe pa konflikt interesi kundrejt dy palëve të kontratës.

Megjithëse qeveria qendrore synon të mos subvencionojë më sektorin për kostot e O&M, duhen vlerësuar me kujdes raste të veçanta të shoqërive, performanca financiare e të cilave lidhet kryesisht me rritjen e tarifave. Për mjaft shoqëri të vogla që kanë sisteme të furnizimit me ujë me ngritje mekanike rritja e kërkuar e tarifave shkon përtej mundësive dhe kritereve të përballueshmërisë së konsumatorëve, prandaj me këto shoqëri duhet të vazhdohet politika e subvencioneve nga qeveria qendrore.

1. Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave

Të dhënat për analizën e performancës së shoqërive UK dhe të sektorit merren nga AKUK, si edhe nga bilancet financiare për vitin 2017 që shoqëritë kanë dorëzuar pranë ERRU. Në mjaft raste vërehet dukshëm që të dhënat përmbajnë pasaktësira të konsiderueshme. Ky fakt reflektohet veçanërisht në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilat hartohen në mënyrë empirike dhe sipërfaqësore për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo sjell si pasojë që treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura rezultojnë me nivel të lartë pasaktësie. Konstatimi vlen edhe për të dhëna të tjera, si gjendja e aseteve, inventari, numri i difekteve në total, apo për km tubacion etj, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të tjerë që lidhen me vlerësimin e performancës së shoqërisë.

Riorganizimi i shoqërive sipas Reformës Territoriale dhe VKM Nr. 63, 27.01.2016, i cili duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2016, akoma nuk ka përfunduar. Deri në fund të vitit 2017 nga totali prej 58 shoqëri UK vetëm 25 prej tyre janë riorganizuar dhe licencuar nga ERRU. Tabela Nr. 32, në Aneksin 1, paraqet në detaje gjendjen e riorganizimit të sektorit për të gjithë shoqëritë UK sipas raportimeve të tyre. Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK duhet të forcojnë angazhimin e tyre për të përfunduar procesin e riorganizimit të tyre me regjistrimin e aseteve dhe hapat e tjerë burokratike të domosdoshëm.

Kjo gjendje mikse e sektorit e vështirëson vlerësimin e performancës së sektorit se akoma mbeten jashtë vlerësimit një pjesë e zonave rurale që me reformën territoriale duhej të ishin përfshirë tashmë në zonën e shërbimit të shoqërive UK. Megjithatë aktualisht janë riorganizuar dhe licencuar 25 shoqëri nga ERRU, pjesa më e madhe e shoqërive raportojnë pranë AKUK me të dhëna për të gjithë zonën, pasi edhe pse të palicencuara ato e kryejnë shërbimin UK edhe për zonën e riorganizuar.

Duke pasur parasysh faktorët e mësipërm për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, hartuesit e raportit kanë bërë përpjekjet maksimale në analizën e të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij pjesën e të dhënave që nuk kanë një bazë justifikimi në lidhje me vërtetësinë e tyre për të eliminuar vlerësimet e gabuara të performancës së sektorit në përgjithësi, si dhe të secilës shoqëri në veçanti.

1.2 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Në Tabelën 2, paraqitet performanca e përgjithshme e sektorit UK për vitin 2017 nëpërmjet 10 Treguesve Kryesorë të Performancës. Në të jepet gjithashtu edhe tendenca e performancës krahasuar me arritjet e vitit 2016, si dhe me objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU.

Tabela 2. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK

Treguesit e Performancës	2016	2017	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
Uji Pa të Ardhura (%)	67.1	65	↗	30
Mbulimi i Kostove O&M (%)	117.9	109	↘	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	89.8	85	↘	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	91.03	92.76	↗	82
Norma e Arkëtimit Korente(%)	78.48	78.84	↗	82
Niveli i Matjes (%)	64.6	68.3	↗	85
Efienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.34	5.50	↘	4/6/10
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	12.3	12	↘	18
Mbulimi me Kanalizime UN (%)	50.7	50.2	↘	75
Mbulimi me F. me Ujë (%)	79.4	78.3	↘	n/a

Burimi: AKUK

Nga tabela e mësipërme vërehet që nivelet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 në përgjithësi kanë tendencë negative, vetëm për treguesit "Uji Pa të Ardhura", "Norma e Arkëtimit korente" dhe "Niveli i Matjes" tendenca është lehtësisht në përmirësim ndërsa Norma e Arkëtimit e Përgjithshme është përmirësuar me 1.73%.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë (mesatarisht 12 orë/ditë), si dhe treguesi i Ujit Pa të Ardhura (65%) krahasuar me vitin 2016 mbeten në vlera të papranueshme. Treguesi i performancës së Efiençës së Stafit (mesatarisht 5,5 staf/1000 lidhje) është përkeqësuar dhe në përgjithësi sektori paraqitet i mbingarkuar me staf sepse edhe gjatë vitit 2017 shoqëritë UK vazhduan të shtojnë numrin e punonjësve në mënyrë të pajustificuar.

1.2.1 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe Mbulimi me Shërbimet e KUN

Referuar raportimeve të bëra nga shoqëritë UK, rezulton se treguesi "Mbulimi me FU" në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 ka pasur tendencë në rënie, nga 79.4% në 78.3%, ndërsa treguesi "Mbulimi me KUN" ka mbetur pothuajse në të njëjtat nivele me një përkeqësim fare të vogël prej 0.5%.

Konstatohet se numri i popullsisë në zonën e juridiksionit për vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 raportohet të jetë shtuar respektivisht me 96 mijë banorë, ndërsa zona e shërbyer është shtuar me 35 mijë banorë, pra nga popullsia e shtuar në zonën e shërbimit të shoqërive UK vetëm 36% e saj përfiton shërbimin e furnizimit me ujë.

Për shërbimin e KUN shkak i luhatjes së vogël negative për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 (0.5%) ka ardhur për shkak se popullsia në juridiksion është rritur me rreth 96 mijë banorë dhe ajo e shërbyer me kanalizime me rreth 25 mijë banorë ose 26% e popullsisë së shtuar në juridiksion.

1.2.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe Mbulimi i Kostos Totale

Viti 2017 krahasuar me vitin 2016 ka shënuar një rënie të këtyre treguesve të Mbulimit të Kostove O&M dhe ato Totale respektivisht me 9% dhe 4.8%. Ky përkeqësim ka ardhur për shkak se Kostot e O&M dhe ato Totale janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, respektivisht me 1.184 milion lekë dhe 1.118 milion lekë, ose në përqindje janë rritur respektivisht 17% dhe 13.6%. Tabela 3 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2016 e 2017 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje.

Tabela 3. Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2016 e 2017

Nr	Zërat e Shpenzimeve	Viti 2016	Viti 2017	Diferenca (2017-2016)	Kostot e Rritura ndaj Totalit (%)
1	Kostot e Punës	3,022,654	3,367,455	344,801	29%
2	Kostot e Energjisë Elektrike	2,319,503	2,516,869	197,366	17%
3	Kostot e Riparimeve	447,020	705,816	258,796	22%
4	Shërbimet nga Nënkontraktorët	359,656	638,394	278,738	23%
5	Kosto e Materialeve e Kimikateve	144,723	162,998	18,275	2%
6	Kosto të Tjera	317,564	337,400	19,836	2%
	Kostot e O&M	6,611,120	7,728,932	1,117,812	95%
7	Kostot e Amortizimit	1,643,882	1,657,834	13,952	1%
8	Të tjera Financiare Tatime Taksa	410,722	462,613	51,891	4%
	Kostot Totale	8,665,724	9,849,379	1,183,655	100%

Arsyet kryesore të rritjes së Kostove Direkte të O&M janë shtimi i madh i numrit të punonjësve (Kostot e Punës), si dhe i zërit të "Shërbimet nga Nënkontraktorët", që në total përbëjnë 52% të kostove të rritura. Nga një analizë e detajuar e secilit zë të kostos në tabelën e mësipërme, vërehet se:

Kosto e Punës Shoqëritë që kanë rritur ndjeshëm numrin e punonjësve (punonjësit e vet dhe ata nga nënkontraktorët) janë shoqëritë UK Tiranë që ka një rritje me 475 punonjës, UK Lushnje me 85 punonjës, UK Shkodër me 63 punonjës, UK Vlorë me 62 punonjës, UK Kavajë me 34 punonjës dhe UK Durrës që ka rritur stafin e saj me 30 punonjës.

Shoqëritë argumentojnë se shtimi i numrit të punonjësve ka ardhur si rezultat i riorganizimit të tyre në përputhje me reformën ku përfshihen mjaft punonjës shtesë të sistemeve të zonave rurale që më parë administroheshin nga vetë ish komunitat, apo punonjësit shtesë që kërkohen për të manaxhuar komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë nga projekte të ndryshme.

Kështu UK Kavajë ka rritur ndjeshëm numrin e punonjësve për shkak të dy projekteve si asete shtesë të UK Kavajë konkretisht "Projekti i furnizimit me ujë për zonën Kavajë, Golem Mali i Robit nga pusçipimet e Çermës Loti I dhe II, si dhe " Projekti zgjerim i IPUN Qerret, Loti II.

UK Durrës e argumenton në mënyrë të detajuar rritjen e numrit të punonjësve, përkatësisht për të realizuar inventarizimin e aseteve shtesë nga riorganizimi i shoqërisë, për azhornimin e lidhjeve UK si dhe pajisjen e tyre me kontratat e shërbimit të FU e KUN, për manaxhimin e rrjeteve të KUN për ish Komunitat Manëz, Ishëm, Sukth etj.

Është konsideruar i nevojshëm shtimi i stafit si rrjedhojë e marrëveshjes që shoqëria ka nënshkruar me Bankën Botërore në vitin 2017 për instalimin e 20 mijë matësve të rinj për klientët ekzistues dhe ato të rinj, si dhe instalimin e matësve kolektivë në disa pallate dhe fshatra me qëllim kontrollin e humbjeve. Po nga kjo marrëveshje u morr në dorëzim edhe autoboti teknologjik për KUN.

Gjithsesi, sektori është i mbingarkuar me staf të pajustifikuar, për të cilën kërkohet një analizë e thelluar për secilën shoqëri në lidhje me numrin e punonjësve dhe pozicionet në organogramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesën reale për çdo pozicion pune.

Faktor tjetër në rritjen e kostove të punës është rritja e fondit të pagave në zbatim të VKM nr. 399 dt. 03.05.2017 " Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" detyrim ligjor i cili sjell kosto shtesë dhe kanë dhënë efektin e tyre në rritjen e kostove të punës.

Në total rritja e raportuar e numrit të stafit dhe e pagës minimale ka sjellë rritjen e Kostove të Punës me rreth 345 milion Lekë.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara Siç u përmend më sipër zëri tjetër që ka sjellë rritje të konsiderueshme të kostove janë shërbimet e nënkontraktuara me të tretët. Rritja e këtyre kostove justifikohet nga shoqëritë me rritjen e numrit të vendrojeve si pasojë e rritjes së komponentëve të ujësjellësit (depo, stacione pompimi, puse etj) nga riorganizimi i shoqërive, komponentë të cilat konsiderohen me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit të popullsisë. Siç është theksuar edhe në raportet e mëparshme legjislacioni për këtë pikë duhet rishikuar për garantimin e sigurisë së objekteve të rëndësishme të veçantë me zgjidhje alternative teknike apo logjistike. Rritja e kostove për shërbimet e kontraktuara me të tretët në krahasim me vitin 2016 ka qenë 279 milion lekë.

Zërat e kostove të punës e të shërbimeve të nënkontraktuara së bashku vlerësohen të jenë rritur në krahasim me vitin 2016 në vlerën prej 624 milion lekë. Rreth 65% të këtyre kostove të rritura i përkasin UK Tiranë me një rritje prej 403 milion lekë, UK Lushnje me 44.6 milion lekë, UK Shkodër me 25.4 milion lekë, UK Vlorë me 25.3 milion lekë si dhe shumë shoqëri të tjera me vlera më të ulëta.

Mjaft pozitiv është fakti se në sektor ka dhe shoqëri që e kanë ulur numrin e të punësuarve rrjedhimisht edhe kostot e punës si UK Fier që i ka ulur këto kosto me 41.3 milion lekë, që edhe pas riorganizimit ku ka marrë zona të reja në juridiksion dhe shërbim nuk e ka shoqëruar me rritje të numrit të stafit operues përkundrazi e ka ulur atë. Në të njëjtën tendencë performance janë gjithashtu dhe shoqëria UK Malësi e Madhe që i ka ulur këto kosto me 27 milion lekë, UK Pogradec me 11.6 milion lekë, si dhe shoqëritë e tjera si U Peqin, Poliçan dhe Kurbin me ulje në vlerë absolute të vogël, që konsiderohen të ndjeshme për këto shoqëri, por që në disa raste ulja e numrit të punonjësve ka ardhur nga faktor të jashtëm riorganizimi sesa nga një mirëmanaxhim i burimeve njerëzore.

Një menaxhim i mirë i shoqërive duhet shoqëruar me menaxhim të mirë të burimeve njerëzore, duke rekrutuar staf të kualifikuar e në përputhje me nevojat, por duke treguar kujdes që ritmet e rritjes së kostove të shoqërohen me rritje të të ardhurave me qëllim që shoqëritë të rikuperojnë kostot e pranueshme dhe të domosdoshme.

Kosto e Energjisë Elektrike Kostot e energjisë për vitin 2017 raportohen shumë të larta krahasuar me ato të vitit 2016 megjithëse çmimi i energjisë elektrike ka mbetur i pandryshuar. Për sektorin UK në total konsumi i energjisë elektrike për vitin 2017 është rritur në krahasim me vitin 2016 me rreth 16 milion kwh. Në të gjithë sektorin konstatohet se 73% e shoqërive kanë rritur kostot e energjisë. Shoqëritë që zënë peshën kryesore në statistikën e rritjes së kostove të energjisë janë, përkatësisht, UK Vlorë me 46.7 milion lekë, UK Durrës me 45.6 milion lekë, UK Lushnje me 43.4 milion lekë, UK Fier me 30.2 milion lekë dhe UK Tiranë me 13.6 milion lekë.

Arsyet e rritjes së konsumit të energjisë elektrike, shoqëritë i justifikojnë në përgjithësi për shkak të riorganizimit të tyre me shtesa të sistemeve të furnizimit me ujë nga zonat rurale që në shumicën e rasteve janë me ngritje mekanike me stacione pompimi. Arsye tjetër që shoqëritë pretendojnë është dhe përkeqësimi i rendimentit të pompave nga amortizimi i mëtejshëm i tyre.

Në veçanti UK Durrës pretendon që e ka rritur konsumin e energjisë elektrike kryesisht për shkak të mbifaturimit nga OSHEE në disa muaj me rreth 3.6 milion kwh, të cilin shoqëria e konsideron abuziv dhe ka bërë ankimin përkatës në OSHEE.

Nga ana tjetër konstatohet se 16 shoqëri kanë raportuar kosto të ulura të energjisë krahasuar me vitin 2016, përkatësisht, U Malësi e Madhe me 23.8 milion lekë si rezultat i riorganizimit zonës së saj të shërbimit nuk i përkasin më disa sisteme të furnizimit me ujë me ngritje mekanike të ish Shkodër Fshat dhe tashmë i përkasin shoqërisë UK Shkodër. Gjithashtu UK Lezhë ka ulje të kostove të energjisë me 20.1 milion lekë, për faktin e përmirësimit të zëvendësimit të pompave me rendiment më të lartë në stacionet e pompimit, si dhe reduktimin e orëve në punë të tyre si rezultat i uljes së humbjeve të ujit të sistemit të ujësjellësit.

UK Kavajë i ka reduktuar kostot me 7.4 milion lekë sepse pas riorganizimit i janë larguar nga zona e shërbimit sistemet e ujësjellësit me ngritje mekanike të ish komunave Lekaj dhe Kryevidh, të cilat i kanë kaluar shoqërisë UK Rrogozhinë. Përmirësime kanë edhe në disa shoqëri të tjera por në vlera relativisht të vogla kundrejt totalit të kostove. Si përfundim, për këtë zë të kostove të O&M, përjashtuar UK Lezhë që përmirësimet kanë ardhur për shkaqe teknike dhe manaxhimi të humbjeve, përmirësimi ka ardhur nga largimi i disa sistemeve me ngritje mekanike nga zona e shërbimit si rezultat i riorganizimit të shoqërive nga reforma administrative dhe ajo e ujit.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve gjatë vitit 2017 krahasuar me ato të vitit 2016 kanë pësuar një rritje të ndjeshme me 259 milion lekë. Difektet në rrjet (çarjet) për vitin 2017 raportohen rreth 42,700 difekte nga 35,793 që ishin në vitin 2016. Rritja e numrit të difekteve justifikohet me shtimin e sistemeve të reja të furnizimit me ujë nga zonat rurale për shkak të riorganizimit të shoqërive, asetet e të cilave rezultojnë mjaft të amortizuara. Një pjesë e rritjes së difekteve në rrjete argumentohet gjithashtu edhe me rritjen e shkallës së amortizimit të aseteve ekzistuese në zonën e shërbimit para riorganizimit, si dhe me zbatimin e planeve të veprimit nga shoqëritë UK për uljen e humbjeve fizike në rrjet.

Pjesa më e konsiderueshme e rritjes së kostove të riparimit i përket UK Tiranë me rreth 173.8 milion lekë, për të vazhduar më tej me UK Durrës me 65.7 milion lekë dhe UK Sarandë me 11 milion lekë. Pozitiv është fakti që 17 shoqëri raportojnë ulje të këtyre shpenzimeve ku uljen më të madhe e ka shënuar U Malësi e Madhe me 13.4 milion lekë dhe vlera më të vogla të uljes së këtyre shpenzimeve i përkasin shoqërive të tjera, si UK Kavajë, UK Gjirokastrë, UK Krujë dhe UK Delvinë.

Përfundimisht duke pasur parasysh totalin e kostove për të gjithë shoqëritë UK rreth 50% e vlerës së rritur të tyre i përket shoqërisë UK Tiranë.

1.2.3 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit me të rëndësishëm të performancës së shoqërive sepse lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimit, përkatësisht Normën e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korente (NAK). NAP në përlllogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, d.m.th. edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK është e përjashtuar nga këto të fundit.

Tabela Nr. 33, Aneksi 2, jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2017 dhe krahasuar ato me vitin 2016. Duke pasur parasysh gjendjen e riorganizimit të sektorit për disa shoqëri vlera e këtyre treguesve është përcaktuar me interpolim.

Të dhënat e ripërpunuara (për vitet 2016 dhe 2017) për kalkulimin e NAP dhe NAK tregojnë se të dy treguesit janë përmirësuar respektivisht me 1.73% dhe 0.36%. Në vlerë absolute vetëm nga debitë e vjetra janë arkëtuar rreth 1.040 milion lekë. Ky rezultat është arritur në sajë të rritjes së angazhimit të shoqërive UK në përgjigje të aksionit të Qeverisë në fushën e ujit nëpërmjet nënshkrimit të aktmarrëveshjeve me klientët për likuidimet e debive të vjetra sipas një kalendarit të përcaktuar. Gjithsesi debia e mbetur për të gjithë sektorin në mbyllje të vitit 2017 është akoma mjaft e lartë me rreth 12.618 milion lekë nga të cilat rreth 10.000 milion lekë i përkasin kategorisë së klientëve familjarë.

Në fakt, vet shoqëritë UK janë debitoare ndaj të tretëve në vlerën rreth 10.000 milion lekë, nga të cilat 50% janë detyrime të papaguara ndaj OSHEE, ndërsa pjesa tjetër janë detyrime ndaj furnitorëve, si dhe për sigurime shoqërore të papaguara. Arkëtimi nga shoqëritë UK në mënyrë sa më të plotë i debive të prapambetura të klientëve do të mund të balanconte mirë kapacitetin e shoqërive UK për të paguar debitë që ato kanë ndaj të tretëve.

Norma e Arkëtimit Korente raportohet për të gjithë sektorin për vitin 2017 në nivelin 78.84% me një përmirësim prej (0.36%) krahasuar me vitin 2016, gjë e cila vlerësohet që rreth 21% e shitjeve të vitit nuk arkëtohet brenda vitit duke iu bashkuar debisë së vjetër. Nëse NAP ka një kufi të rritjes së saj sepse një pjesë e mirë e debive të vjetra janë debi të këqija (praktikisht të pamundura për t'u mbledhur), NAK tregon se shoqëritë po performojnë dobët në përqindjen e numrit total të klientëve që ato faturojnë, pra që nuk arrijnë ti mbledhin pagesat e faturave. Shoqëritë duhet të punojnë fort në arkëtimin e shitjeve aktuale dhe atyre të prapambetura me anë të një angazhimi maksimal të stafit të tyre.

Nga shembujt pozitivë që performojnë me normë të lartë arkëtimi korente përmenden shoqëritë UK Maliq, UK Ersekë, UK Berat-Kuçovë dhe U Gramsh, ndërsa disa nga shoqëritë që operojnë me normë arkëtimi korente shumë të ulët janë përkatësisht, UK Rrogozhinë, UK Tropojë, UK Kukës, UK Vlorë dhe UK Peshkopi.

1.2.4 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit që përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje merr rëndësi të veçantë sepse zëri i pagave të punonjësve së bashku me zërin e energjisë elektrike zënë pjesën kryesore të kostove për O&M të shoqërisë. Nga ana tjetër ky tregues përcakton shkallën e manaxhimit efektiv të burimeve njerëzore. Konstatohet që gjatë vitit 2017 numri total i punonjësve në sektorin UK është rritur me 947 punonjës nga të cilët 571 janë të punësuarit e rinj të shoqërive dhe 376 të punësuarit shtesë nga nënkontraktorët, të cilët i shërbejnë shoqërive UK që shpesh nuk duket i justifikuar.

Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit për vitin 2017 është mesatarisht 5,5 staf/1000 lidhje UK, që tregon se sektori është i mbingarkuar me staf. Pavarësisht se sektorit gjatë vitit 2017 i janë shtuar 134.712 lidhje ose konsumatorë krahasuar me vitin 2016, ky tregues është përkeqësuar në vlerën e 0.17 punonjës për 1.000 lidhje UK krahasuar me një vit më parë. Referuar këtij treguesi nga eksperiencia botërore dhe në rajon, përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish. Vetëm pak shoqëri, si UK Korçë, plotësojnë kushtin ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore. Nga ana tjetër, zgjerimi i

zonës së shërbimit që rezulton në shtim të lidhjeve të reja për zonat e pa shërbyera më parë, ka dhënë efektet e veta edhe në drejtim të rritjes së numrit të punonjësve të shoqërive UK.

Gjithsesi ky tregues nuk mund të përgjithësohet apriori, por duhet analizuar për secilën shoqëri UK duhen marrë parasysh specifikat e operimit dhe ofrimit të shërbimit të tyre. Në mjaft raste ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të veçorive që paraqesin komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në plotësim të detyrimeve ligjore në garantim të sigurisë së këtyre veprave me personel roje. Kështu në ato zona shërbimi ku sistemet e furnizimit me ujë kanë një numër të madh deposh, pusesh etj, shoqëritë paraqesin në organigramën e tyre një numër mjaft të madh punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte.

Është theksuar edhe në raportin e vitit 2016 që ky problem duhet konsideruar për t'i dhënë zgjidhje teknike sigurisë së këtyre objekteve për të mos rritur artificialisht dhe në mënyrë të panevojshme kostot e fuqisë punëtore në shoqëritë UK.

Nga ana tjetër duhet pranuar që është një problem evident në sektorin UK problemi i punësimit të njerëzve nga shoqëritë UK jo mbi baza të nevojave reale edhe sipas kualifikimeve të duhura për stafin.

Një kontribut për përmirësimin e politikave të punësimit në drejtim të numrit real të punonjësve në shoqëritë UK duhet të japë ERRU duke analizuar me hollësi argumentat e organigramës për numrin e punonjësve dhe secilin pozicion që duhet të paraqesin shoqëritë UK kur aplikojnë për tarifa të reja, pagat e të cilëve janë pjesë e kostos së tarifave të propozuara.

1.2.5 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Treguesi "Uji Pa të Ardhura" për vitin 2017 në rang sektori rezultoi në nivelin 65%, pra është përmirësuar duke u ulur me 2% krahasuar me vitin 2016, por gjithsesi mbetet akoma në nivele të papranueshme. Në vlerë absolute sasia e ujit të prodhuar në vitin 2017 në sektor është rreth 286 milion m³ ujë, pra rreth 11.5 milion m³ ujë më pak se në vitin 2016. Ndërkohë aspekt tjetër pozitiv është fakti se sasia e ujit të faturuar ka pësuar rritje me 3.4 milion m³ më shumë ujë të faturuar krahasuar me vitin paraardhës.

Ka pesë vite që shoqëritë depozitojnë pranë ERRU-së Bilancin e Ujit, i cili presupozohet të jetë një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin e humbjeve teknike dhe administrative. Shoqëritë raportojnë rregullisht bilancet e ujit, por cilësia e përgatitjes së tyre është larg qëllimit për të cilat ato hartohen. Pikënisja e gabuar e hartimit të tyre është se shpesh llogaritja e sasisë së ujit të prodhuar bëhet me vlerësim (jo me matje) për shkak të mungesës së ujëmatësave në puset, stacionet e pompimit, rezervuarët dhe në ndarjet zonale të rrjeteve shpërndarëse të furnizimit me ujë. Nga ana tjetër hartimi i një bilanci të saktë uji e kufizon edhe mungesa e pajisjes 100% të të gjithë konsumatorëve individualë të shoqërive UK.

Gjithsesi konstatohet që edhe stafet manaxheriale të shoqërive UK nuk bëjnë përpjekjet maksimale për të gjetur mënyra vlerësimi ad-hoc për elemente të ndryshëm të bilancit (humbjet teknike dhe ato administrative), p.sh. për të vlerësuar mbifaturimet e ndryshme, lidhjet e paligjshme, elemente të veçanta të sistemit ku mund të përcaktohen humbjet teknike për t'i përgjithësuar ato për të gjithë sistemin, etj. Saktësia në përcaktimin e tyre çon në hartimin e planeve të veprimit efektive për uljen e humbjeve, sidomos ato administrative me kosto minimale, pra kryesisht angazhim stafi.

Faktor korigjues që duhet marrë parasysh është gjithashtu se në përgjithësi sistemet e furnizimit me ujë operojnë me regjim jo të vazhdueshëm të furnizimit me ujë (shumë prej tyre nën 8 orë) gjë e cila e rrit më tej pabesueshmërinë ose fiktivitetin e vlerësimit të UPA. Për sa më sipër edhe përfundimet në lidhje me vlerësimin e UPA si sektor dhe përmirësimi i këtij treguesi në vitin 2017 me 2% krahasuar me vitin 2016 duhet marrë me rezervë.

1.2.6 Niveli i Matjes

Treguesi i Nivelit të Matjes për vitin 2017 është 68,3%, tregues i cili duhet konsideruar relativisht i ulët. Duke pasur parasysh riorganizimin e shoqërive me ndarjen e re administrative, aktualisht asnjë shoqëri UK nuk i ka të pajisur 100% të konsumatorëve me matës, madje në disa shoqëri ky tregues është në nivelin nën 10%. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre. Pjesa e konsumatorëve që paguajnë për sasi uji pa matje (aforfe 150 litra/ditë/banor) nuk është korrekte dhe mbart në vetvete padrejtësi dhe abuzim. Kjo për faktin se shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të presupozuar, ndërkohë që një pjesë e tyre konsumojnë shumë më tepër për ujitje (shtëpia private dhe zona rurale). Në disa raste shoqërive u vjen përshtat financiarisht faturimi aforfe, por kjo shpeshherë stimulon mbikëmbim të ujit në zona të caktuara duke cenuar cilësinë e shërbimit (orët e furnizimit dhe presionet) në zonat shpërndarëse mbas tyre sidomos gjatë stinës së nxehtë.

Pajisja 100% me ujëmatës në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë duhet të jetë prioritet bazë i shoqërive UK dhe i mundësisë të financimit të tyre nga qeveria qendrore.

Shoqëritë UK për vitin 2017 kanë raportuar instalimin e 63 820 ujëmatësave më shumë krahasuar me vitin 2016, por akoma sektori është larg objektivit për të pajisur 100% të konsumatorëve me matës.

Në kuadër dhe të Reformës në fushën e ujit të ndërmarrë nga qeveria instalimi i ujëmatësve është një ndër prioritetet e saj. Pajisja me ujëmatës i gjithë sistemit duhet të jetë një nga objektivat kryesor të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e manaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbikëmbimit në sisteme.

1.2.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Për vitin 2017 treguesi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë për sektorin mbetet mesatarisht në vlerën 12 orë/ditë. Kjo vlerë mesatare është e papranueshme, për të mos përmendur që mjaft shoqëri kanë një vlerë mjaft të ulët të saj deri në 2-3 orë në ditë. Ky tregues nuk përfaqëson vetëm anën cilësore të shërbimit i cili duhet të jetë pandërprerje, por lidhet mjaft edhe me problemet e rrezikut të shëndetit të publikut nga mundësia e futjes në tubacione të ujërave nëntokësore të ndotura gjatë kohës që tubacionet janë bosh madje dhe nën presion negativ.

Me riorganizimin e ri të shoqërive, aktualisht vetëm UK Librazhd ka furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur. Referuar të dhënave të vitit 2017, rezulton se popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëritë UK në fshat është rritur me rreth 35% krahasuar me vitin 2015 (para fillimit të reformës territoriale). Kohëzgjatja e furnizimit me ujë në këto zona është më e ulët se në zonat urbane, gjë e cila ka ndikuar edhe në rezultatin e përgjithshëm të këtij treguesi. Kjo është arsyeja që edhe shoqëritë e mëparshme të Korçës, Librazhdit, Pogradecit dhe Devollit që më parë furnizonin me ujë 24/7 të gjithë zonën e shërbimit, tashmë nuk mund të konsiderohen më të tilla.

Gjithsesi mund të themi që ky është një tregues që përgjithësisht llogaritet vetëm duke u nisur nga koha e zbrazjes së depos dhe për mjaft zona të rrjetit shpërndarës paraqitet mjaft fiktiv.

1.3 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.3.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet

Tabela Nr.34 në Aneksin 3 jep për çdo shoqëri UK të ardhurat nga faturimet duke i krahasuar ato me kostot e O&M dhe ato Totale në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje, dhe rezultatin përkatës financiar vjetor me humbje ose fitim. Në të jepen gjithashtu edhe nevojat reale për subvencione për të mbuluar kostot e O&M. Tabela jep gjithashtu dhe bilancin e të ardhurave të vitit 2017 krahasuar me të ardhurat e vitit 2016.

Në detaje rritjen më të madhe të të ardhurave nga shitja dhe të ardhurave të tjera që lidhen me aktivitetin UK kanë realizuar shoqëritë e mëdha, përkatësisht, UK Tiranë me 296 milion lekë, UK Durrës me 74 milion lekë, UK Shkodër me 32.4 milion lekë dhe UK Korçë me 24.6 milion lekë. Arsyeja kryesore e rritjes së të ardhurave qëndron kryesisht në forcimin e angazhimit të shoqërive për mbledhjen e tyre maksimalisht që çon në shëndoshjen financiare të shoqërive UK.

UK Fier megjithëse ka rezultate të mira në përmirësimin e treguesve të performancës në përgjithësi, gjatë vitit 2017 ka ulur ndjeshëm të ardhurat me 70.7 milion lekë, kjo për shkak të largimit të një prej klientëve të tij më të rëndësishëm në drejtim të konsumit me një sasi të konsiderueshme uji, Uzina e Përpunimit të Naftës (ARMO).

Analiza konstaton gjithashtu se nivelet e mbulimit të kostove në shoqëritë e vogla e të mesme janë përmirësuar krahasuar me vitin 2016, por gjithsesi influenza e tyre në sektor në vlerë absolute nuk është e konsiderueshme. Progresi i performancës financiare i shënuar tek shoqëritë e vogla nuk arrin të krijojë një bilanc financiar pozitiv të operimit të tyre, rrjedhimisht ato do të vazhdojnë të jenë subjekt i nevojës për subvencione nga qeveria qendrore.

Nga analiza financiare vjetore që jepet në Tabelën Nr. 34 në Aneksin Nr. 3 në sektor rezulton se vetëm 18 shoqëri nga 58 arrijnë të mbulojnë kostot O&M, nga të cilat 3 prej tyre arrijnë të mbulojnë edhe kostot totale.

Në detaje situata financiare për çdo shoqëri UK për vitin 2017 në drejtim të shpenzimeve, të ardhurave dhe nevojës për subvencione jepet në Tabelën Nr. 34 në Aneksin Nr. 3.

Referuar kësaj table rezulton se nevoja reale për subvencione për të mbuluar shpenzimet e O&M për të gjithë sektorin është 1,251,324 lekë (rreth 9,6 milion euro). Nga ana tjetër vihet re që 67% të totalit të nevojës për subvencione i përkasin shoqërive, *Durrës (23%) , Vlorë (15%), Patos (14%), Lushnje (5%), Kavajë (4.5%) dhe Kurbin (4.5%)*. *Për shëndoshjen financiare të sektorit vëmendja kryesore duhet fokusuar në problematikat e këtyre shoqërive, në veçanti për shoqëritë UK Durrës, Vlorë dhe Patos për një analizë më të thelluar të performancës së tyre për të përcaktuar shkaqet e performancës së dobët financiare të tyre, si dhe Plan Veprimet për përmirësimin e tyre.*

Tabela Nr. 35 në Aneksin Nr. 4 jep një pasqyrë të detajuar të nevojës për subvencione për vitin 2017, si dhe akordimin real (shpërndarjen) për çdo shoqëri UK.

Nga tabela konstatohet që për vitin 2017 sektori UK është subvencionuar me një vlerë totale prej 1.039 milion lekë (rreth 8 milion euro) e ndarë në 1.000 milion nga buxheti i shtetit, nga të cilat 800 milion për mbulimin e diferencës kosto-çmim dhe 200 milion lekë për vlerësimin e performancës së shoqërive. Bashkitë nga fondet e tyre kanë dhënë subvencione për shoqëritë në shumën 39 milion lekë.

Nga shpërndarja reale e subvencioneve shihet se për disa shoqëri ato janë akorduar mbi nevojat reale të mbulimit të shpenzimeve për O&M, ndërsa në disa të tjera janë akorduar nën nevojat reale të tyre. Nuk

njihet arsyeja dhe kriteret e përdorura të shpërndarjes së subvencioneve sipas situatës që jep tabela e mësipërme, por gjithsesi kërkohet më shumë transparencë për mënyrën e shpërndarjes së fondeve të subvencioneve në të ardhmen.

1.3.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK

Ky Raport nuk merr përsipër një analizë të detajuar të investimeve në sektorin UK. Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit. Në vitin 2017 si edhe në vitet paraardhëse, burimet kryesore të financimit, kanë qenë buxheti i shtetit dhe financimi nga donatorët e huaj në formën e huave apo granteve në raporte përafërsisht të barabarta. Këto investime janë fokusuar kryesisht në rehabilitimin e sistemeve të ujësjellës e KUN si edhe në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Tabela 4 paraqet investimet që janë kryer gjatë vitit 2016 dhe 2017 të ndara sipas vlerave, burimit të financimit dhe destinacioneve, përkatësisht, në sisteme të furnizimit me ujë, në kanalizimet e ujërave të ndotura, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Tabela 4. Investimet e Kryera në Sektor, Viti 2016 dhe 2017 sipas Burimit dhe Destinacionit

		000/lekë	
Emërtimi		Viti 2016	Viti 2017
Burimi i Financimit	Financim i Huaj	8,504,013	6,435,508
	Financim nga Buxheti	4,108,555	4,194,097
Total		12,612,568	10,629,605
Destinacioni	Ujësjellës	4,950,000	5,000,000
	Kanalizime	4,712,568	2,900,000
	ITUN	2,950,000	2,729,605

Burimi: Njësia e Monitorimit në AKUK

Nevojat për investime në sektorin UK paraqiten në mënyrë të detajuar në Masterplanin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime për Shqipërinë për periudhën 2011-2040 financuar nga KfW. Masterplani parashikon nevojat për investime në sektorin UK në vlerën e 6 miliard Euro, përkatësisht 4 miliard Euro për sektorin e KUN dhe ITUN, 1 miliard Euro për sektorin e ujësjellësave dhe pjesa tjetër për shërbimet inxhinjerike, nevojë e projektuar deri në vitin 2040. Kjo vlerë përkon mesatarisht me një nevojë për financim prej rreth 270 milion Euro në vit. Vlera e financimit paraqitet mjaft e lartë në lidhje me mundësitë reale të financimit të tij, financim i cili në 10 vitet e fundit ka rezultuar në shifrat rreth 50-60 milion euro në vit përfshirë të gjitha burimet e financimit të tij, pra buxheti i shtetit dhe donatorët.

Master Plani në fakt ka vlerësuar nevojat për investime vetëm në territorin brenda zonës së shërbimit të shoqërive UK para reformës administrative territoriale. Studimi nuk përfshinte në vlerësim nevojat për investime për të ashtuquajturat “zona gri” të territorit të 131 ish komunave ku shërbimet e furnizimit me ujë dhe KUN manaxhoheshin nga vetë këto të fundit, si dhe te “zonat e bardha” në të cilat nuk ekzistonin fare sisteme inxhinjerike të furnizimit me ujë dhe KUN. Për këto arsye si dhe për nevojën e riindeksimit të çmimeve të vlerësimit të nevojave është e nevojshme rishikimi i këtij studimi, i cili i projektuar për një

periudhë kohore deri në vitin 2040 duhet të marrë parasysh nevojat për investime edhe për “zonat gri” e “zonat e bardha”.

Në Maj 2016 u hartua dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit Ujësor të Kanalizimeve në Shqipëri (draft), e cila përfshin një model për financimin e sektorit, por që akoma nuk është miratuar me ndonjë Vendim të Këshillit të Ministrave. Ky model identifikoi kostot për arritjen e objektivave të sektorit, burimet e ndryshme të financimit për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të tij (3T-të) si dhe këto kosto të jenë të përballueshme nga konsumatorët. Financimi i sektorit me 3T ka parasysh financimin nga burime të brendshme financiare të shoqërive të gjeneruara nga aktiviteti i saj (tarifa), financime nga qeveria qendrore (taksa), dhe së fundi nga donatorët (transferta).

Sipas këtij modeli, elementi i ri në lidhje me bëshmërinë e skemës së financimit të nevojave për investime fizike në sektor është mbulimi i një pjese të konsiderueshme të financimit nga vetë shoqëritë. Analiza në lidhje me përballueshmërinë e pagesës nga konsumatorët referuar të ardhurave mesatare të tyre, tregoi se ka mjaft hapësirë për rritjen e tarifave në mënyrë që të përmirësohet gjendja financiare e shoqërive për të gjeneruar të ardhura për të mbuluar një pjesë të nevojave për financim të tyre. Gjithsesi në varësi edhe të vlerave të nevojës për investime që do të përcaktohen nga Master Plani Kombëtar i shikuar, duhen përditësuar gjithashtu të dhënat në këtë Strategji që duhet miratuar përfundimisht me vendim të veçantë të KM.

1.4 Agregimi

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në sektor mbulohen nga rreth 58 shoqëri UK, nga të cilat vetëm 2 shoqëri të bashkive Tiranë dhe Durrës mbulojnë rreth gjysmën e popullsisë efektive të vendit. *Një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me rreth 58 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta.*

Vendi ynë është në prag të hapjes së negociatave për pranimin në Bashkimin Europian. Me hapjen e negociatave pritet që Bashkimi Europian të alokojë fonde të konsiderueshme për sektorin e ujit në përmbushje të standarteve të Direktivës së Ujit të KE. *Një sektor i fragmentarizuar ka kapacitete mjaft të kufizuara për përthithjen e këtyre fondeve.* Nga eksperiencia e mëparshme të vendeve pas hapjes së negociatave për në BE si Bullgaria dhe Rumania, përthithja e këtyre fondeve nga një sektor i fragmentarizuar bëhet me vështirësi, dhe në fund veprat e ndërtuara prej tyre rezultuan me kosto operimi dhe mirëmbajtje (O&M) të pajustificueshme nga ana ekonomike.

Agregimi i shoqërive UK, si shprehje tipike e avantazhit të ekonomisë së shkallës, propozohet si zgjidhje dhe instrument i domosdoshëm që bën të mundur jo vetëm përthithjen me të shpejtë në sasi të këtyre fondeve, por më tej, veprat e realizuara prej tyre kanë kosto O&M ekonomikisht efikase.

Nëse vërejmë rezultatet financiare të sektorit UK, rreth 45 % të nevojave për subvencione e kanë shoqëritë UK të dimensionit të mesëm, pra me nga 3.000-15.000 lidhje ose klientë. Këto shoqëri përfshijnë rreth 30 shoqëri UK dhe përgjithësisht karakterizohen me një performancë të dobët, pra rreth 2/3 e tyre nuk i mbulojnë kostot e O&M. Natyrisht edhe nëse shëndoshet gjendja financiare e dy shoqërive UK Durrës dhe UK Vlorë të grupit të parë të madh të shoqërive UK, ky grup evidentohet akoma më shumë si më problematiku në performancën në sektor.

Për këtë arsye strategjia e agregimit të sektorit duhet të fokusohet në grupin e dimensionit të mesëm të shoqërive UK. Më tej shoqëritë e vogla (janë rreth 14 të tilla) nuk zënë ndonjë peshë të rëndësishme në sektor kanë premisa dhe shanse të shtuara për t'u agreguar me të parat.

Në vendin tonë gjatë gjithë fazës së tranzicionit është realizuar vetëm agregimi i shoqërisë Berat-Kuçovë, i cili gjithsesi ka probleme të performancës dhe manaxhimit të tij. Agregimi në vetvete është një proces kompleks e delikat ku ndërthuren mjaft faktorë objektivë dhe subjektivë (politike, ekonomike, gjeografike, sociale etj.), por në themel të realizimit të suksesshëm të tij qëndron konkluzioni i studimit të bëshmërisë për agregimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve në vendin tonë dhe se *agregimi duhet realizuar në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore.*

Për sa më sipër është vështirë të hartohet një strategji agregimi realiste e sektorit me objektiva afatshkurtër kohor për reduktimin e numrit të shoqërive. Agregimi duhet të realizohet me anë të një studimi mjaft të kujdesshëm që paralelisht me reformën *të realizohet një shembull pilot agregimi i suksesshëm* i dy ose më shumë shoqërive UK në sektor. Realizimi me sukses do të shërbejë si shembull bëshmërie i realizimit të strategjisë së sektorit për t'u zhvilluar në shkallë të gjerë në periudhën afatmesme. Për këtë duhet *të financohet një studim bëshmërie për rastin pilot të agregimit* që do të marrë parasysh angazhimin vullnetar për realizimin e tij nga dy ose më shumë njësi vendore, dhe që do të mbështetet me incentiva (financime) me investime fizike nga qeveria qendrore nga buxheti ose donatorët.

Nga ana tjetër, duhet pasur kujdes dhe angazhim me shërbime të specializuara konsulence përpilimi i Marrëveshjeve të Agregimit ndërmjet bashkive me të drejta dhe detyrime të barabarta, si dhe me një rregullim peshe të voteve për vendime të rëndësishme të shoqërisë për të eliminuar vendimet arbitrare të bashkive që mund të kenë mbi 50% të aksioneve në shoqërinë UK të agreguar, duke marrë parasysh edhe rolin e Rregullatorit në këtë proces.

2. Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Për vitin 2017, monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjellës i bazuar në 9 tregues kryesorë të performancës të cituara më sipër dhe të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator është disi më ndryshe pasi pjesa më e madhe e shoqërive janë riorganizuar dhe raportimet e tyre janë bërë në bazë të këtij statusi. Gjithashtu kemi dhe shoqëri të cilat nuk japin më shërbim, i cili u ka kaluar shoqërive të tjera, nga ana tjetër kemi dhe shoqëri të reja për të cilat nuk kemi historik të treguesve të performancës.

Në këtë raport ne nuk kemi informacion lidhur me katër shoqëri të reja konkretisht: U Bashkia Shijak, UK Bashkia Klos, UK Finiq dhe U Dropull, detyrimisht këto shoqëri nuk kanë si të përfshihen në analizën e performancës.

Gjithashtu kemi dhe 5 shoqëri UK Cërrik, UK Roskovec, U Pustec, UK Vorë dhe U Konispol, të cilat kanë raportuar të dhëna vetëm për vitin 2017 dhe treguesit e llogaritur nuk mund të krahasohen me ato të një viti më parë pasi nuk kanë historik pasi janë shoqëri të reja të organizuara sipas reformës territoriale. Në këtë grup shtohet edhe shoqëria UK Kamëz e cila nuk është analizuar në vitet e mëparshme pasi ka qenë pjesë e UK Tiranë dhe për rrjedhojë nuk e analizojmë edhe në këtë vit.

Pra nga 58 shoqëri UK procesi i analizës dhe ecures si dhe krahasimi me vitin paraardhës do të bëhet vetëm për 48 shoqëri të ndara në grupe respektive. E theksojmë faktin se shoqëritë, U Gjirokastrë fshat, U Shkodër fshat, U Lushnje fshat si dhe UK Fushë Krujë janë bashkangjitur respektivisht UK Gjirokastrë, UK Shkodër Qytet, UK Lushnje dhe UK Krujë dhe krahasimi me vitin paraardhës nuk është real. Gjithashtu AKUK ka bashkuar të dhënat e dy shoqërive UK Elbasan dhe U Elbasan Fshat në një të vetme, (me idenë se të tilla duhet të jenë sipas riorganizimit) prandaj dhe ERRU e detyruar për të bërë krahasimin ka bashkuar dhe të dhënat (e vitit) 2016 në një të vetme edhe pse aktualisht këto shoqëri funksionojnë të veçanta. Janë dhe shumë shoqëri të tjera që janë riorganizuar dhe si të tilla krahasimi me vitin paraardhës nuk është bindës për të gjykuar se si shoqëritë kanë performuar.

Edhe në këtë raport performance ne do të përdorim të njëjtën metodologji si në ndarjen në grupe të shoqërive ashtu dhe në vlerësimin e treguesve të tyre, por krahasueshmëria me vitin/vitet paraardhës do të shqyrtohet në varësi të statusit të çdo shoqërie (e riorganizuar apo jo sipas Reformës Territoriale). Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimet më të rëndësishme të punës së operatorëve duke na dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për nivelin e ofruar të shërbimeve.

Tabela 5. Grupet e shoqërive

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup	Numri i shoqërive që do të analizohen në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës	12	11
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës	28	26
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës	18	11

Vo: Katër shoqëri nuk kanë dhënë informacion për vitin 2017 dhe gjashtë shoqëri janë shoqëri të reja dhe kanë raportuar vetëm për vitin 2017, nuk kanë historik të të dhënave (krahasimi i situatës aktuale me vitin 2016 nuk mund të kryhet).

Tabela 6. Ndarja e shoqërive në tre grupe

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
GRUPI 1			GRUPI 2 (vijon)		
UK	Tiranë	233,946	UK	Mat	4,400
UK	Durrës	79,917	UK	Rrogozhine	4,385
UK	Vlorë	52,076	U	Përmet	4,182
UK	Elbasan	40,598	U	Ura-Vajgurore	4,161
UK	Fier	35,265	U	Malësi e Madhe	4,068
UK	Berat-Kuçovë	28,056	U	Divjake	4,019
UK	Korçë	28,053	U	Selenice	3,867
UK	Shkodër	27,327	U	Peqin	3,750
UK	Kavajë	24,190	U	Vau Dejës	3,418
UK	Lushnje	21,444	UK	Skrapar	3,294
UK	Sarandë	18,674	UK	Roskovec	3,267
UK	Kamëz	15,976	GRUPI 3		
GRUPI 2			U	Tropojë	2,944
UK	Pogradec	14,741	U	Bulqizë	2,845
UK	Lezhë	12,795	UK	Delvine	2,842
UK	Gjirokastër	10,123	UK	Mirditë	2,692
UK	Peshkopi	8,824	U	Poliçan	2,500
U	Kurbin	7,543	U	Konispol	2,184
UK	Cërrik	6,872	UK	Kolonjë	2,088
UK	Belsh	6,508	UK	Vore	1,835
UK	Maliq	6,337	U	Këlcyre	1,554
UK	Himarë	6,296	U	Has	1,429
UK	Krujë	6,126	UK	Libohovë.	1,301
UK	Devoll	6,099	UK	Puke	1,121
U	Gramsh	5,831	UK	Pustec	739
UK	Kukës	5,774	UK	Fushë Arrëz	600
U	Patos	5,723	U	Bashkia Shijak	-
UK	Librazhd	5,461	UK	Bashkia Klos	-
UK	Mallakastër	5,056	UK	Finiq	-
UK	Tepelenë	4,414	U	Dropull	-

Burimi i informacionit nga AKUK

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme. Në tabelën Nr. 7 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa në grafikun 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP.

Figura 1. Shembull i Grafikëve të Analizës së TKP-ve




Tabela 7. Objektivat e synuar për treguesit kryesorë të performancës

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat e vendosura		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Eficienca e Stafit (numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje) ¹	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji pa të ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

¹ Për TKP Eficienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.3.1 Uji Pa të Ardhura

Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Për vitin 2017, treguesi Uji pa të Ardhura në sektor është 65%, është përmirësuar me 2,1% krahasuar me vitin 2016. Reduktimi i sasisë së ujit të prodhuar me rreth 11,5 milion m³, si dhe rritja e faturimit me rreth 3,4 milion m³ ka bërë që ky tregues të jetë në nivelin e sipërcituar. Reforma administrativo territoriale në sektorin UK si dhe përpjekjet e shoqërive për një menaxhim të mirë të shoqërive janë faktorët që kanë ndikuar mbi treguesin UPA. ERRU vazhdimisht thekson se menaxhimi më i mirë i kompanive, hartimi i planeve të biznesit dhe përfshirja në to e planeve të veprimit për përmirësimin e treguesve të performancës do të sjellë ndryshimet e kërkuara në sektorin UK.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2017




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për grupin e I-rë, viti 2017

Në grupin e parë të përbërë nga 11 shoqëri UK, vetëm UK Korçë me nivel të treguesit 28,46% vazhdon të mbetet nën kufirin e performancës së mirë, ndërsa 10 (dhjetë) shoqëri performojnë dobët me nivelin e ujit pa të ardhura nga 60-80 %. Përmirësimi i nivelit të lartë të humbjeve të ujit në këtë grup ndikon direkt edhe në përmirësimin e humbjeve në sektor pasi në total rreth 74% të lidhjeve për furnizimin me ujë administrohen nga shoqëritë e këtij grupi.

Tendencë përmirësimi të ujit pa të ardhura kanë paraqitur UK Shkodër (- 9,10%), UK Sarandë (-6,4%), UK Berat-Kuçovë (-3,41%), UK Vlorë (-2,82%) etj. UK Shkodër ka përmirësuar treguesin si pasojë e eliminimit të humbjeve nga lidhje të paligjshme dhe riparimit të defekteve në rrjetin shpërndarës ndërsa për UK Berat - Kuçovë (-3.41%) përmirësimi i treguesit ka ardhur si pasojë e rritjes së ujit të faturuar dhe riorganizimit të shoqërive. Gjithashtu, UK Sarandë nëpërmjet një manaxhimi më të mirë ka arritur të përmirësojë treguesin me (-6,4%).

Tabela 8. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Shkodër UK	72.95	69.11	60.01	-9.10 *
Sarandë UK	78.01	77.20	70.80	-6.40
Berat - Kuçovë UK	76.30	83.47	80.06	-3.41
Vlorë UK	82.25	81.01	78.19	-2.82
Korçë UK	25.94	30.01	28.46	-1.55
Tiranë UK	66.81	67.77	66.97	-0.80
Durrës UK	71.90	71.59	71.24	-0.35
Lushnje U	79.21	78.19	78.42	0.23
Fier UK	61.33	61.58	65.73	4.15
Elbasan UK	75.93	67.00	75.22	8.22
Kavajë UK	43.93	54.06	62.83	8.77

***Shënim** : Për këtë tregues shenja (-) tregon përmirësim të performancës.

Tendencë në përkeqësim të treguesit, si rezultat i riorganizimit të shoqërive, paraqesin Sha UK Kavajë (+8.77%), Sha UK Elbasan (+8.22%) dhe Sha UK Fier (+4,15%).

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Grupi 2 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për grupin e II-të, viti 2017

Në grupin e dytë të shoqërive vetëm UK Devoll performon nën kufirin 30% të Benchmarking, 11 prej tyre performojnë dobët dhe pjesa tjetër performon keq duke patur nivelin e humbjeve mbi 50%. Aksioni për vendosjen e matësave në të gjitha kategoritë e konsumatorëve, investimet në rrjetin shpërndarës dhe transmetues kanë bërë të mundur që niveli i humbjeve të pësojë rënie për UK Vau i Dejës (-19,74%), UK Devoll (-9,2%) dhe UK Lezhë (-8,38%). Tendencë në rënie të treguesit paraqesin shoqëritë UK Mallakastër, UK Maliq, UK Kurbin, UK Rrogozhinë etj.

Më poshtë në tabelën 9, jepet ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për tre vitet e fundit në grupin e dytë.

Tabela 9. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Selenicë U		91.00	59.86	-31.14
Peshkopi UK	62.97	57.65	33.55	-24.10
Vau i Dejës UK	76.77	74.94	55.20	-19.74
Kukës UK	13.15	52.79	43.33	-9.46
Devoll UK	24.92	20.94	11.74	-9.20
Lezhë UK	46.50	47.64	39.26	-8.38
Mallakastër UK	56.52	56.62	48.86	-7.76
Maliq UK	33.66	38.29	31.36	-6.93
Kurbin U	73.01	71.44	67.55	-3.89
Rrogozhinë UK	49.59	68.79	64.91	-3.88
Skrapar UK	54.29	59.19	55.50	-3.69
Gjirokastrë UK	71.27	67.72	65.52	-2.20
Krujë UK	57.08	62.29	61.29	-1.00
Pogradec UK	46.66	30.91	31.50	0.59
Ura Vajgurore U	56.70	59.91	61.02	1.11
Mat UK	40.25	38.18	39.40	1.22
Divjakë U	49.87	48.98	53.55	4.57
Përmet U	46.45	38.79	44.46	5.67
Peqin UK	48.83	45.53	51.69	6.16
Belsh UK		27.00	33.42	6.42
Patos U	47.38	49.49	60.24	10.75
Gramsh U	49.82	30.63	41.84	11.21
Himarë UK		22.00	34.92	12.92
Tepelenë UK	61.49	63.61	80.15	16.54
Malësi e Madhe UK	33.07	37.53	60.74	23.21
Librazhd UK	23.12	36.29	73.39	37.10

Raportim jo i saktë i sasisë së ujit të prodhuar dhe atij të faturuar, pranë ERRU (Bilanci i ujit) dhe AKUK për vitin 2017, e bën të pabesueshëm nivelin e ujit pa të ardhura për UK Peshkopi (33,55%), UK Kukës (43,33%), UK Librazhd (+37,7%) si dhe nuk ka paraqitur trendin real për UK Selenicë me (-31,14%), UK Tepelenë me (+16,54%). UK Himarë, me nivel të humbjeve 34,92%, vazhdon të raportojë të dhëna jo të sakta në AKUK pasi në seancën dëgjimore, në aplikimin për propozimin e nivelit të ri tarifor, niveli i humbjeve u paraqit në 80,08%. Kanë performuar keq, me nivel të lartë të ujit pa të ardhura, UK Tepelenë (80,15%), UK Librazhd (73,39%), UK Kurbin (67,55%), U Malësia e madhe (60,74%), UK Gjirokastrë

(65,52%) etj. Në këtë grup raportojnë për herë të parë shoqëritë e reja UK Roskovec (60,34%) dhe UK Cërrik (60,24%).

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Grupi 3 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për grupin e III-të, viti 2017

Në grupin e tretë, asnjë prej shoqërive nuk performon nën kufirin 30% të performancës së mirë. Niveli i humbjeve mbi 50% për të gjitha këto shoqëri paraqet domosdoshmërinë për përmirësim në drejtim të manaxhimit dhe nevojën urgjente për investime të reja. Mungesa e matësave në pikat e prodhimit apo në depo, vlerësimi jo i saktë i sasisë së ujit të prodhuar është një fenomen që shoqëron pothuaj të gjitha shoqëritë e këtij grupi.

Në vitin 2017, përpjekje për përmirësimin e gjendjes, duke treguar një trend pozitiv në reduktimin e humbjeve kanë bërë 6 nga 11 shoqëri të këtij grupi. Eliminimi i lidhjeve të paligjshme, investimet në ujëmatës për konsumatorët është shkaku i përmirësimit të humbjeve me (-13,26%) për U Poliçan. Efekti i përmirësimit të nivelit të humbjeve për UK Mirditë me (-7,86%) është pasojë e riorganizimit në sektor pasi UK Rubik me nivel të humbjeve 37% është përfshirë nën juridiksionin e UK Mirditë për vitin 2017. Të njëjtën gjë nuk mund ta themi për UK Libohovë pasi bashkimi i saj me dy njësi të reja administrative ka përkeqësuar këtë tregues në (+17,28%).

Ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për tre vitet e fundit në grupin e tretë jepet si më poshtë në tabelën 10.

Tabela 10. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Poliçan U	69.05	69.44	56.18	-13.26
Mirditë UK	66.14	60.02	52.16	-7.86
Bulqizë U	61.97	54.75	52.42	-2.33
Fushë Arrëz U	75.08	70.54	68.29	-2.25
Has UK	56.10	52.28	50.12	-2.16
Bashkia Pukë UK	60.19	77.02	76.52	-0.50
Tropojë U	71.71	61.86	62.43	0.57
Kolonjë UK	47.46	51.46	52.23	0.77
Këlcyrë U	83.66	77.57	80.21	2.64
Delvinë UK	24.11	62.87	66.39	3.52
Libohovë UK	27.56	66.51	83.79	17.28

Kanë pësuar rënie të treguesit, ndonëse në vlera jo të mëdha, UK Delvinë (+3,52%), UK Këlcyrë (+2,64%) etj. Raportojnë për herë të pare për këtë tregues UK Vorë (58%) dhe UK Pustec (73%).

Përfundime

Niveli i Ujit Pa të Ardhura në 65%, tregon që trendi në rënie i këtij treguesi është prezent edhe për vitin 2017. Krahasuar me vitin e kaluar, reduktimi i Ujit Pa të Ardhura me 2%, paraqet efektin që kanë dhënë në sektorin UK manaxhimi i përmirësuar i shoqërive, reforma territoriale dhe reforma në sektorin e ujit. Numri i shoqërive që performojnë mirë në sektor me nivel të Ujit Pa të Ardhura rreth 30% ka pësuar rënie, nga 6 shoqëri vetëm 2 performojnë brenda këtij kufiri. Kanë paraqitur performancë të dobët, me nivel të humbjeve nga 30-50 %, vetëm 13 shoqëri UK, ndërsa numri i shoqërive që performojnë keq është rritur nga 36 në 38 shoqëri.

Gjatë analizës së tre grupeve u vu re se reforma administrative në shoqëri të ndryshme ka dhënë efekt pozitiv dhe negativ, kjo në varësi të performancës së njësive administrative që i bashkohen apo i largohen shoqërisë ekzistuese. Akoma më shqetësuese mbetet për ERRU mos raportimi i saktë i disa prej shoqërive UK të cilat bëjnë të mundur që treguesi të mos ketë të njëjtat nivele të raportuara në ERRU dhe AKUK. Gjithashtu, mungesa e matësve në prodhim si dhe vlerësimi jo korrekt i sasisë së ujit të prodhuar shpesh ka sjell dhe luhatje të mëdha të këtij treguesi.

Angazhimi për marrjen e masave të duhura dhe hartimi i planeve të veprimit për të reduktuar shpenzimet e panevojshme që lindin nga mbiprodhimi si dhe menaxhimi i mirë i humbjeve komerciale (dukshme) dhe atyre teknik (reale) mbetet emergjente për shumicën e shoqërive UK. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj, rritja e faturimit dhe arkëtimit, vendosja e matësve në prodhim dhe shpërndarje mbetet emergjente për të gjitha shoqëritë për të përmirësuar situatën e tyre financiare.

ERRU është e gatshme të mbështesë të gjitha shoqëritë UK në punën e tyre nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese që ajo harton për sektorin. Gjithashtu sugjeron të gjitha shoqëritë UK që nëpërmjet "Bilancit të Ujit", i cili ende nuk hartohet saktë nga shumë shoqëri ose neglizhohet prej tyre, të vlerësojnë situatën aktuale dhe të hartojnë planet e veprimit për të realizuar reduktimin e ujit pa të ardhura që edhe për këtë vit qëndron larg kufirit strategjik të vendosur e cila për vitin 2017 duhet të ishte në nivelin 40%.

2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i kostove O&M” është treguesi që pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij, (pa kostot kapitale dhe të amortizimit). Aktualisht ky është një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie.

Në vitin 2017, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 109% nga 117.9% që ishte në vitin paraardhës. Sektori në këtë tregues ka pësuar një rënie e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së kostove në nivele shumë më të larta se rritja e të ardhurave nga aktiviteti UK dhe të ardhurave të tjera që lidhen me të. Ky tregues e ka arritur objektivin e strategjisë së sektorit dhe performancës së mirë të ERRU që në vitin 2013, pasi kostot e operimit dhe mirëmbajtjes duke filluar nga ky vit janë mbuluar mbi 100%. Nga ana tjetër ERRU konstaton se ky tregues edhe pse mbetet në nivel të lartë mbi 100%, brenda shoqërive për vitin 2017 ka patur rënie të tij krahasuar me vitin 2016.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Në grupin e parë, bëjnë pjesë shoqëritë më të mëdha, një pjesë e të cilave për disa vite rresht arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%.

Niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë 100% i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 5 shoqëri, UK Korçë, UK Tiranë, UK Berat-Kuçovë, UK Sarandë si dhe UK Fier.




Figura 5. Mbulimi i kostove O&M për grupin e I-rë, viti 2017.

Janë tre shoqëri që i përkasin brezit të performancës së dobët dhe konkretisht UK Lushnje, UK Kavajë dhe UK Vlorë.

Në brezin e performancës së pranueshme janë 3 shoqëri, UK Elbasan, UK Shkodër dhe UK Durrës.

Në tabelën 11, si më poshtë paraqitet ecuria e treguesit mbulimi i Kostove O&M për tre vitet e fundit.

Tabela 11. Ecuria e Treguesit Mbulimi i kostove O&M për grupin e I-rë

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)*
Korçë UK	194.28	157.00	173.00	16.00
Berat - Kuçovë UK	139.00	127.00	131.00	4.00
Sarandë UK	132.53	118.65	122.00	3.35
Tiranë UK	151.00	157.00	159.00	2.00
Kavajë UK	67.00	63.00	64.00	1.00
Elbasan UK	97.00	100.46	95.00	5.46
Shkodër UK	108.06	104.31	98.00	6.31
Durrës UK	66.48	88.44	80.00	8.44
Vlorë UK	88.34	75.27	62.00	13.27
Fier UK	121.61	126.85	103.00	23.85
Lushnje UK	90.00	99.00	70.00	29.00

Krahasuar më vitin 2016 në këtë grup pesë shoqëri kanë pasur përmirësim në mbulimin e kostonë së operimit dhe mirëmbajtjes për vitin 2016 duke rritur shkallën e mbulimit të kostove O&M nga 1% deri në 16% ku progresin më të madh e ka shënuar UK Korçë.

Kjo shoqëri është riorganizuar sipas reformës territoriale duke marrë zonat rurale që shërbeheshin nga Ujësjellësi Korçë fshat si dhe zona të pambuluara me shërbim. Manaxhimi i shoqërisë ka punuar mirë në drejtim të mbajtjes nën kontroll të kostove të operim mirëmbajtjes. Përmirësim kanë pasur dhe shoqëritë UK Berat-Kuçovë, UK Sarandë, UK Tiranë dhe UK Kavajë.

Rënie të ndjeshme të këtij treguesi kanë pësuar UK Lushnje (-29%) kjo dhe si rezultat i bashkimit me U Lushnje fshat që ka çuar në rritje të kostove. UK Fier i cili edhe pse futet në operatorët që i mbulon këto kosto mbi 100% këtë vit ka shënuar një regres të madh (-23.85%). Gjithashtu edhe UK Shkodër ka shënuar regres të treguesit i cili për disa vite ka qenë në nivelin mbi 100% dhe tashmë ka kaluar në nivelin 98% ndërsa UK Durrës është fiksuar në nivelin minimal të performancës së pranueshme (80%) duke pësuar rënie me (-8.44%).

Si grup niveli mesatar i mbulimit të kostove O&M për vitin 2017 ka shënuar progres me 2% krahasuar me vitin 2016.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Në këtë grup për vitin 2017, janë 26 shoqëri të cilat janë analizuar dhe krahasuar me vitin 2016. Edhe në këtë grup evidentohen 10 shoqëri që kanë arritur të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100% dhe renditen si shoqëri me performancë të mirë. Shoqëria me mbulim më të mirë të kostove O&M është UK Lezhë me 162% dhe me një përmirësim (+37.46%) krahasuar me vitin paraardhës, e ndjekur nga UK Devoll me 144%, UK Kukës me 124% e me radhë dhe nga shtatë shoqëri të tjera deri tek UK Gjirokastrë me 104% sipas grafikut.

Grupi 2 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 6. Mbulimi i kostove O&M për grupin e II-të, viti 2017

Në zonën e performancës së dobët nën 80% renditen 15 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët me 19% mbulim kosto O&M është U Patos.

Në brezin e performancës së pranueshme, mbi 80%, janë renditur gjashtë shoqëri. Për UK Krujë, UK Tepelenë dhe U Ura Vajgurore regresi ka bërë që nga performanca e pranueshme të kalojnë në brezin e performancës së dobët.

Për vitin 2017 treguesi mesatar i mbulimit të kostove të operim mirëmbajtjes për grupin e dytë është 77% nga 63% që ishte në vitin 2016. Kjo tregon përpjekjet e këtyre shoqërive për të rritur nivelin e mbulimit të kostove gjë që reflektohet dhe në tabelën e ecurisë së këtij treguesi.

Ecuria e këtij treguesi për grupin e dytë gjatë tre viteve të fundit paraqitet si më poshtë në tabelën 12.

Tabela 12. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për Grupin e II-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Malësi e Madhe UK	50.78	41.38	111.00	69.62
Devoll UK	95.00	93.00	144.00	51.00
Lezhë UK	117.66	124.54	162.00	37.46
Kukës UK	102.00	97.00	124.00	27.00
Selenicë U	38.80	42.60	65.00	22.40
Vau i Dejës UK	44.00	26.30	48.00	21.70
Rrogozhinë UK	71.00	51.00	65.00	14.00
Pogradec UK	127.00	110.00	123.00	13.00
Belsh UK		60.67	73.00	12.33
Himarë UK*		70.00	78.00	8.00
Skrapar UK	40.00	35.70	43.00	7.30
Kurbin U	41.28	43.21	47.00	3.79
Peqin UK	64.02	49.72	52.00	2.28
Divjakë U	66.00	51.00	53.00	2.00
Patos UK	17.91	18.42	19.00	0.58
Gramsh U	110.00	104.00	104.00	0.00
Përmet U	75.51	75.11	73.00	2.11
Librazhd	100.00	118.00	115.00	3.00
Mat UK	121.00	127.00	123.00	4.00
Mallakastër UK	65.61	47.34	42.00	5.34
Ura Vajgurore U	56.00	82.00	76.00	6.00
Maliq UK	52.14	67.93	59.00	8.93
Peshkopi UK	114.76	116.86	93.00	23.86
Tepelenë UK	53.01	85.54	58.00	27.54
Gjirokastër UK	124.00	135.00	104.00	31.00
Krujë UK	108.62	98.33	60.00	38.33

***Shënim:** Për shoqërinë UK Himarë të dhënat janë regulluar sipas bilancit financiar pasi rezultonin me diferenca të mëdha.

Nga 26 shoqëri të këtij grupi, 15 shoqëri e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016. Përmirësimi në mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes varion nga 0.58% deri në 69.62%. Përmirësimin më të madh e ka shënuar U Malësi e Madhe me (69.62%) e cila nga niveli mjaft i dobët në vitin 2016 ku mbulonte kostot O&M në masën 41% për vitin 2017 është në nivelin 111%. Kjo shoqëri ka ulur ndjeshëm kostot e punës dhe ato të energjisë respektivisht me (-26.9 milion) dhe (-23.8 milion). Riorganizimi i shoqërisë ka dhënë efektin pozitiv pasi shoqëria zhvillon aktivitetin me 62 punonjës nga 142 që ishin në vitin 2016 (ish Shkodër fshat e cila është shpërbërë). Gjithashtu sistemet e ujësjellësit kryesisht janë me vetërrjedhje dhe kanë pak kosto energjie. Shoqëria U Gramsh ka arritur një stabilitet në këtë tregues dhe për të dytin vit radhazi është fiksuar në nivelin 104%. Edhe kjo është shoqëri e licencuar sipas VKM nr. 63 por që tregon stabilitet dhe manaxhim të mirë nga drejtuesit e saj.

Në këtë grup ka shoqëri si UK Gjirokastër, UK Mat dhe UK Librazhd të cilat edhe pse kanë performancë shumë të mirë (mbi 100%) kanë shënuar regres për vitin 2017 respektivisht (-31%), (-4%) dhe (-3%). Rënia

e këtij treguesi për UK Mat ka ardhur nga fakti se si kostot dhe të ardhurat kanë pasur ecuri negative ku kostot janë rritur me + 8 milion lekë dhe të ardhurat janë ulur me - 6 milion lekë. Gjithashtu dhe për dy shoqëritë e tjera rritja e kostove është në nivel më të lartë se rritja e të ardhurave.

Rënie të ndjeshme të treguesit mbulimi i kostove O&M ka patur U Peshkopi me (-23.86%) që e ka zbritur këtë shoqëri nga niveli i performancës shumë të mirë me mbi 100% në nivelin e performancës së pranueshme (93%). Kjo shoqëri raporton për vitin 2017 kosto të rritura me 18 milion lekë kurse të ardhurat janë rritur me 10 milion lekë. Raportimet janë bërë si shoqëri e riorganizuar (si dhe shumë shoqëri të tjera) ku dhe krahasimi në vitin paraardhës nuk është real.

Edhe UK Krujë (e riorganizuar dhe licencuar nga ERRU ku është bashkuar me Fushë Krujën) në tabelë renditet me rënie me (-38.33%), por që nuk është reale pasi krahasohet UK Krujë 2016 me UK Krujë +UK Fushë Krujë 2017.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Grupi 3 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 7. Mbulimi i kostove O&M për grupin e III-të, viti 2017

Objektivi i vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për të mbuluar tërësisht kostot O&M është arritur nga 2 shoqëri, UK Kolonjë me 144% dhe UK Tropojë me 105%.

Në zonën e performancës së pranueshme për vitin 2017 janë dy shoqëri dhe konkretisht U Bulqizë dhe U Delvinë respektivisht 85.77% dhe 80%.

Shoqëria me performancën më të dobët është U Libohovë që mbulon 48.03% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

Ecuria e treguesit mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes për grupin e tretë gjatë tre viteve të fundit paraqitet si më poshtë në tabelën 13.

Tabela 13. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për grupin e III-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Delvinë UK	83.61	41.00	80.00	39.00
Kolonjë UK	84.00	117.00	144.00	27.00
Poliçan U	32.75	34.57	61.00	26.43
Fushë Arrëz U	47.08	56.11	63.00	6.89
Bulqizë U	103.00	81.00	85.77	4.77
Këlcyrë U	58.03	59.77	63.00	3.23
Has UK	41.51	59.04	62.00	2.96
Libohovë UK	41.53	46.66	48.03	1.37
Tropojë U	92.18	105.16	105.00	0.16
Mirditë UK	56.75	69.75	68.00	1.75
Bashkia Pukë UK	100.00	103.00	77.00	26.00

Për shoqëritë e grupit të tretë, mbulimi i kostove O&M në vitin 2017 ka pasur tendencë pozitive krahasuar me vitin 2016 për pjesën më të madhe të shoqërive, por megjithatë nivelet e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes mbeten të ulëta. Rritja e shkallës së mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 varion nga 1.37% për UK Libohovë në 39% për U Delvinë.

Bashkia Pukë ka shënuar regresin më të madh të grupit me (-26%) që e ka renditur këtë shoqëri nga performanca shumë e mirë me nivelin 103% për vitin 2016 në atë të performancës së dobët me 77% për vitin 2017. Ulje në nivel të vogël (-1.75%) ka shënuar UK Mirditë.

Përfundime

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2017 është përkeqësuar krahasuar me vitin 2016. Nga 48 shoqëri të analizuar 17 prej tyre kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 8 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 23 shoqëri janë në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 6 shoqëri të cilat nuk mbulojnë as 50% të kostove O&M nga 18 që ishin në vitin 2016. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot dhe vazhdimësia e aktivitetit të tyre mbështetet nga subvencionimi i buxhetit të shtetit.

Edhe pse jo të marra në analizën krahasimore me vitin 2016, por që kanë raportuar të dhëna për vitin 2017 janë dhe 5 shoqëri të reja dhe konkretisht UK Cërrik dhe UK Roskovec që i takojnë grupit të dytë dhe mbulojnë kostot O&M respektivisht 81% dhe 70%, si dhe shoqëri të grupit të tretë dhe konkretisht: UK Vorë me 88%, UK Pustec me 71% si dhe U Konispol me 41%.

UK Kamëz nuk është analizuar në vitet e mëparshme pasi ka qenë pjesë e UK Tiranë dhe këtë vit nuk është përfshirë në analizën krahasimore, pasi nuk ka bazë krahasimi. Sipas informacionit të dhënë pranë AKUK kjo shoqëri raporton mbulimin e kostove O&M në masën 174%, edhe pse është shoqëri e palicencuar dhe pa tarifa të miratuara nga ERRU.

ERRU nisur nga fakti që niveli mesatar i mbulimit të kostove O&M për vitin 2017 ka rënë krahasuar me vitin 2016 brenda shoqërive konstatohet një përmirësim i ndjeshëm i këtij treguesi, kjo kryesisht në shoqëritë e mesme dhe të vogla, pra kanë bërë progres më të ndjeshëm se ai i vitit 2016. Nga ana tjetër efekti pozitiv i grupit të dytë e të tretë të mos jetë i konsiderueshëm në treguesin e mbulimit të kostove

O&M, pasi pesha specifike e kostove dhe të ardhurave për shoqëritë e mëdha (grupi i parë) është dominuese në rezultatin e sektorit UK. Konkretisht kostot e grupit të parë zënë 76% të totalit të kostove OM kundrejt 24 % që i takojnë shoqërive të grupit të dytë e të tretë. Po kështu dhe të ardhurat respektivisht 83% me 17%.

ERRU vazhdon ta konsiderojë mbulimin tërësor të kostove O&M nga shoqëritë, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Ndryshimi i tarifave luan një rol të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave të shoqërisë dhe për rrjedhojë edhe në mbulimin e kostove. Vendosja e tarifave sa më të drejta kërkon vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer. Për ERRU ndarja e shpenzimeve sipas qendrave të kosos merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur krahas tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të miratojë për disa shoqëri edhe tarifat për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura. ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se përmirësimi i situatës financiare të shoqërive UK duhet të vijë jo vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga një manaxhim i mirë i burimeve teknike e financiare.

2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale

Objektivi i çdo shoqërie duhet të jetë mbulimi i Kostos Totale me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shërbimet e tjera të aktivitetit. Për vitin 2017, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 85% duke shënuar një rënie prej rreth 4.8% krahasuar me vitin 2016. Në vitin 2017, objektivi strategjik (80%) dhe ai i performancës së mirë të ERRU (80%) i këtij treguesi për sektorin është tejkaluar, që tregon një zhvillim edhe më pozitiv.

Grupi i I-ë i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Në grupin e parë janë 5 shoqëri të cilat janë në nivelin e performancës së mirë mbi 80% nga të cilat vetëm UK Tiranë mbulon kostot totale në masën 129% nga 138% që i kishte në vitin 2016.

Në zonën e performancës së pranueshme janë 3 shoqëri : UK Durrës me 73%, UK Shkodër me 72% si dhe UK Elbasan me 67% e cila ka shënuar regresin më të madh me (-21%).




Figura 8. Mbulimi i kostove Totale për Grupin e I-rë, Viti 2017

Në brezin e performancës së dobët nga një shoqëri në vitin 2016 si rrjedhojë e përkeqësimit të këtij treguesi numërohen 3 shoqëri UK Kavajë, UK Lushnje dhe UK Vlorë, shoqëri të cilat ishin në po të njëjtën situatë dhe në mbulimet e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

UK Kavajë edhe pse ka bërë përpjekje për uljen e kostove me (19,5 milion lekë) dhe rritje të të ardhurave me (6 milion lekë), duke përmirësuar treguesin, vazhdon për disa vite rresht në këtë brez performance. Për UK Lushnje dhe UK Vlorë ka rritje të konsiderueshme të kostove respektivisht +137.3 milion lekë dhe +85.8 milion lekë por njëkohësisht dhe rritje të të ardhurave me +44.7 milion lekë dhe +12.4 milion lekë. Këto rritje të dy variablave që përlllogarisin nivelin e mbulimit të kostove O&M janë të justifikuara pasi këto shoqëri janë të riorganizuara duke zgjeruar zonën e shërbimit. Në këtë rast dhe konkluzioni për rënien e këtij treguesi mund të mos konsiderohet i tillë pasi krahasojmë shoqëri të riorganizuara (2017) me shoqëritë ekzistuese (2016), por gjithsesi ky është konstatim i situatës aktuale.

Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e parë sipas tre viteve të fundit paraqitet në tabelën 14 si më poshtë.

Tabela 14. Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e I-rë

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Sarandë UK	86.00	88.00	92.00	4.00
Kavajë UK	45.33	39.01	42.00	2.99
Korçë UK	86.72	98.60	98.00	0.60
Durrës UK	55.78	76.15	73.00	3.15
Berat - Kuçovë UK	104.00	98.00	94.00	4.00
Shkodër UK	76.85	78.65	72.00	6.65
Vlorë UK	63.31	51.85	45.00	6.85
Tiranë UK	121.00	138.00	129.00	9.00
Elbasan UK	76.00	76.86	67.00	9.86
Fier UK	92.76	102.72	88.00	14.72
Lushnje UK	62.00	65.00	49.00	16.00

Janë 9 shoqëri që për vitin 2017 kanë rezultuar me tendencë në rënie të këtij treguesi dhe vetëm dy shoqëri konkretisht UK Sarandë dhe UK Kavajë që e kanë përmirësuar treguesin respektivisht me 4% dhe 2.99%.

Për UK Korçë, viti 2017 është viti i parë i regresit të saj për këtë tregues kjo për faktin e riorganizimit të shoqërisë dhe rritja e kostove është në nivel më të lartë se rritja e të ardhurave. UK Tiranë edhe pse e vetmja shoqëri me mbulimin mbi 100%, këtë vit ka shënuar rënie të treguesit me 9%. Kjo shoqëri sikurse e theksuam dhe tek situata e sektorit (tendenca) ka rritur kostot në një masë të konsiderueshme e cila nuk është shoqëruar me rritje të ardhurash me qëllim mbulimin e kostove dhe pesha e saj ndaj totalit të shoqërive jep efekt të madh.

Edhe në këtë raport e theksojmë që shoqëria UK Sarandë vazhdon për disa vite rresht të ketë trend pozitiv të këtij treguesi dhe është shoqëria me përmirësimin më të mirë në grup. Pothuajse të gjitha shoqëritë kanë patur luhajtje pozitive e negative për të tre vitet rresht.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Në grupin e dytë, objektivi i ERRU për performancë të mirë është tejkaluar nga 8 prej 26 shoqërive të këtij grupi. Në këtë grup asnjë shoqëri nuk arrin të mbulojë kostot totale mbi 100%.

Grupi 2 - Mbulimi i Kostos Totale (%)




Figura 9. Mbulimi i kostove Totale për grupin e II-të, viti 2017

Në brezin e performancës së pranueshme janë 8 shoqëri të cilat duken qartë dhe nga grafiku dhe konkretisht janë shoqëritë nga U Gramsh deri tek UK Maliq. Edhe UK Cërrik, si një shoqëri e re i përket këtij brezi performues me nivel mbulimi 77%.

Në brezin e performancës së dobët pra në nivelin nën 50% janë 9 shoqëri, sipas grafikut nga U Patos e cila renditet e fundit me 18% deri te UK Peqin me 48%. Të shtatë shoqëritë e tjera janë brenda këtij intervali.

Më poshtë në tabelën 15 paraqitet ecuria sa i përket treguesit të mbulimit të kostove Totale për grupin e dytë.

Tabela 15. Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e II-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Malësi e Madhe UK	36.29	31.99	83.00	51.01
Selenicë U	26.82	28.94	53.00	24.06
Kukës UK	71.00	71.00	93.00	22.00
Ura Vajgurore U	66.41	51.96	67.00	15.04
Belsh UK		58.73	69.00	10.27
Rrogozhinë UK	36.62	47.20	55.00	7.80
Vau i Dejës UK	24.88	25.19	30.00	4.81
Divjakë U	45.81	43.52	48.00	4.48
Pogradec UK	56.00	54.00	58.00	4.00
Himarë UK		67.00	70.00	3.00
Devoll UK	94.00	92.00	95.00	3.00
Kurbin U	39.05	39.05	42.00	2.95
Peqin UK	59.45	46.69	48.00	1.31
Përmet U	67.92	69.12	70.00	0.88
Patos UK	17.08	17.39	18.00	0.61
Skrapar UK	29.04	36.38	34.00	2.38
Gramsh U	87.00	84.00	79.00	5.00
Mallakastër UK	60.80	44.47	38.00	6.47
Maliq UK	42.19	57.69	51.00	6.69
Gjirokastër UK	112.00	104.00	96.00	8.00
Tepelenë UK	42.73	54.47	46.00	8.47
Librazhd UK	99.00	100.00	89.00	11.00
Lezhë UK	70.24	95.52	83.00	12.52
Krujë UK	44.49	56.52	42.00	14.52
Mat UK	120.00	102.00	83.00	19.00
Peshkopi UK	91.62	106.50	85.00	21.50

Duke krahasuar vitin 2017 me vitin 2016 sipas tabelës së mësipërme duket qartë që tendencën pozitive më të mirë e ka pasur UK Malësi e Madhe (+51.01%), UK Selenicë (+24%), UK Kukës (+22%) e me radhë 11 shoqëritë e tjera deri tek U Patos me (+0.61%)

Në grupin e dytë janë 11 shoqëri që kanë shënuar rënie të këtij treguesi e cila varion nga -21.5% në -2.38%. Rënien më të madhe e ka U Peshkopi me (-21.5%) si dhe UK Mat me (-19%). Të dyja këto shoqëri nga mbulimi mbi 100% kanë mbetur në brezin e performancës së mirë por kanë shënuar rënie të nivelit të treguesit. Edhe UK Gjirokastër është në të njëjtën situatë performon mirë, por po shënon regres nga viti në vit. Pra shoqëritë e këtij grupi janë shumë heterogjene në lidhje me ecurinë e këtij treguesi.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Në grupin e tretë janë 11 shoqëri të marra në analizë lidhur me nivelin e mbulimit të kostove totale për vitin 2017 nga 18 që janë të listuar në këtë grup.

Grupi 3 - Mbulimi i Kostos Totale (%)




Figura 10. Mbulimi i kostove Totale për grupin e III-të, viti 2017

Në nivelin e performancës së mirë është vetëm UK Kolonjë me nivelin 128% ose 21% më mirë se viti paraardhës.

Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi, 8 prej tyre, bëjnë pjesë në brezin e performancës së pranueshme ku U Tropojë është në nivelin më të lartë me 80% ndërsa shoqëritë e tjera variojnë nga 50 % në 71%. Performuesi më i dobët i grupit është UK Mirditë me nivelin 36% të mbulimit të kostove.

Në tabelën 16 si më poshtë paraqitet ecuria e shoqërive të këtij treguesi sipas tre viteve të fundit për grupin e tretë.

Tabela 16. Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e III-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Poliçan U	29.66	31.44	57.00	25.56
Ersekë U	78.00	107.00	128.00	21.00
Delvinë UK	75.10	38.00	57.00	19.00
Fushë Arrëz UK	37.69	41.77	50.00	8.23
Has UK	34.40	44.29	51.00	6.71
Libohovë U	35.68	40.72	47.00	6.28
Këlcyrë UK	54.22	54.78	58.00	3.22
Mirditë UK	52.35	33.91	36.00	2.09
Tropojë U	63.33	78.93	80.00	1.07
Bulqizë UK	75.00	77.94	71.00	6.94
Bashkia Pukë U	79.00	82.00	62.00	20.00

Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi në vitin 2017 kanë përmirësuar shkallën e mbulimit të kostove totale ndonëse disa prej tyre në nivele minimale, por gjithsesi shprehin përmirësim i cili varion nga 1.07 % deri në 25.56%. Krahasuar me vitin 2016 ecurinë më të mirë gjatë vitit 2017 e ka pasur UK Poliçan me (+25.56%) që e ka çuar këtë shoqëri nga performanca e dobët në atë të pranueshme. Edhe pse në këtë grup performanca është e dobët përse i përket mbulimit të kostove totale, shoqëritë bëjnë përpjekje për t'u përmirësuar, por duke qenë se nivelet e mbulimit janë të ulëta përmirësimi nuk e ndryshon situatën e dobët financiare të tyre.

Dy janë shoqëritë e këtij grupi që kanë shënuar regres UK Bulqizë me (-6.94%), por që mbetet në brezin e performancës së pranueshme. Regresi më i madh në mbulimin e kostos totale është regjistruar nga Bashkia Pukë me (-20%) që e ka klasifikuar shoqërinë nga performues i mirë në brezin e performancës së pranueshme.

Përfundime

Në vitin 2017, niveli i mbulimit të kostos totale ka shënuar regres me rreth 5%. Në sektor numërohen 16 shoqëri që mbulojnë kostot totale me mbi 80% dhe nga këto 3 shoqëri i mbulojnë ato mbi 100%, ndërsa një vit më parë vetëm 4 shoqëri mbulonin 100% kostot totale. Në pamje të parë duket se performanca e shoqërive përse i përket mbulimit të kostove totale për shërbimet e ofruara është përmirësuar, por nga analiza e performancës së shoqërive UK sipas grupeve rezulton se shumë shoqëri të grupit të dytë dhe veçanërisht ato të grupit të tretë, janë shumë larg përballimit të këtyre kostove pa ndihmën e subvencioneve. Në sektor numërohen 13 shoqëri që mbulojnë kostot totale deri 50% nga 25 që ishin në vitin 2016 gjë që tregon përpjekje të shoqërive për shëndoshje financiare, por shumë larg pavarësisë financiare.

Peshën më të madhe në treguesin Mbulimi i Kostove Totale e kanë shoqëritë e grupit të parë të cilat minimizojnë impaktin e përmirësimit të shoqërive të vogla e të mesme. Konkretisht ndaj totalit të kostove shoqëritë e grupit të parë përfaqësojnë 75%, grupi i dytë 21% dhe grupi i tretë 4%, po kështu dhe për të ardhurat respektivisht grupet zënë 83%, 15% dhe 2%. Pra sado të përmirësohen shoqëritë e vogla dhe të mesme efekti pozitiv do të ndihet tek ato vetë sepse ndikimi në sektor është shumë i vogël.

2.3.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës kanalizime. Ky tregues na lejon të kuptojmë se sa efektive është një shoqëri për të garantuar likuiditetin e saj. Në thelb, performanca e mirë në lidhje me normën e arkëtimit është funksion manaxherial. ERRU në analizën e shoqërive sipas grupeve ka kalkuluar si për vitin 2017 ashtu dhe për vitin 2016 Normën e Arkëtimit Korente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin korent. Gjithashtu është kalkuluar dhe Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku janë përfshirë dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues, kjo e ripunuar dhe për vitin 2016. Pra për këtë tregues në dallim nga treguesit e tjerë krahasimi i shoqërive do të bëhet vetëm me vitin paraardhës.

Për vitin 2017 NAP është 92.76 % kundrejt 91.03% që është përlogaritur në vitin 2016. Nga debitë e prapambetura gjatë vitit 2017 janë arkëtuar rreth 1040 milion lekë, ose 19% më shumë se në vitin 2016.

Kjo tregon për një angazhim serioz të shoqërive duke marrë masa për arkëtimet e detyrimeve të prapambetura të klientëve ndaj shoqërive UK.

Në analizën e grupeve fokusi do të jetë NAK pasi tregon qartë punën e shoqërive në drejtim të efijencës së mbledhjes së të ardhurave të vitit korent. Niveli i saj për vitin 2017 është 78.84% kundrejt 78.48% që ishte në vitin 2016, pra pothuajse në të njëjtin nivel të dyja vitet me një ndryshim të vogël pozitiv me (+0.36%)

Performanca për vitin 2017

Grupi i I-rë i Shoqërive




Figura 11. Norma e Arkëtimit Korente për grupin e I-rë, Viti 2017

Në grupin e parë, shoqëritë me performancën më të mirë me mbi 82% të këtij treguesi për vitin 2017 janë UK Tiranë me 86.24%, UK Berat Kuçovë me 85.86% si dhe UK Kavajë me 82.98%. Në brezin e performancës së pranueshme (60% deri 82%) janë pjesa tjetër e shoqërive. Në këtë grup nuk është asnjë shoqëri që performon dobët.

Më poshtë në Tabelën 17 paraqitet ecuria e treguesit Norma e Arkëtimit Korente për grupin e parë.

Tabela 17. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për grupin e I-rë

Operatori	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Fier UK	62.02	77.02	15.00
Lushnje UK	57.17	70.28	13.11
Sarandë U	62.13	74.42	12.29
Kavajë UK	79.02	82.98	3.96
Shkodër UK	62.51	65.10	2.59
Berat - Kuçovë UK	83.32	85.86	2.55
Korçë UK	79.00	79.93	0.93
Tiranë UK	86.11	86.24	0.13
Vlorë UK	66.19	64.48	1.70
Durrës UK	76.60	67.77	8.82
Elbasan UK	74.36	60.08	14.28

Në grupin e parë përmirësimi në mbledhjen e të ardhurave krahasuar me një vit më parë varion nga 0.13% deri në 15%. Nga 11 shoqëri tetë prej tyre kanë shënuar progres ndërsa tre shoqëri kanë pësuar rënie krahasuar me vitin 2016. Rënien më të ndjeshme e ka UK Elbasan por edhe në këtë tregues për këtë shoqëri nuk ka saktësi maksimale pasi është bërë bashkim mekanik i dy shoqërive UK Elbasan me U Elbasan fshat. Pra mbetet UK Durrës me tendencën negative më të madhe me (-8.82%) krahasuar me vitin 2016.

Shoqëritë që kanë përmirësuar ndjeshëm këtë tregues janë UK Fier (15%), UK Lushnje (13.11%) dhe UK Sarandë (12.29%).

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Grupi 2 - Norma e Arkëtimit Korente (%)




Figura 12. Norma e Arkëtimit Korente për grupin e II-të, Viti 2017

Në grupin e dytë nga 26 shoqëri të paraqitura në grafik, 9 kanë arritur nivelin e normës së arkëtimit mbi 82% që është niveli i performancës së mirë i përcaktuar nga ERRU nga 12 që ishin në vitin 2016.

Në grupin e dytë këtë vit është futur dhe UK Cërrik një shoqëri e re e formuar në kuadër të riorganizimit të shoqërive UK sipas reformës administrative territoriale, e cila në grafik paraqitet vetëm me një shtyllë atë të vitit 2017 ku norma e arkëtimit korent është 89.41% dhe kjo shoqëri bën pjesë në performuesit e mirë.

Në brezin e performancës së pranueshme janë 14 shoqëri duke filluar nga UK Vau Dejës me 81.36% deri te UK Kukës me 60.19%. Në këtë grup janë tre shoqëri që janë në brezin e kuq, pra dobët UK Rrogozhinë, UK Peshkopi dhe UK Malësi e Madhe e cila ka normën e arkëtimit më të ulët të grupit të dytë 54.85%.

Ecuria e treguesit të Normës së Arkëtimit Korente për grupin e dytë të shoqërive paraqitet në tabelën 18 si më poshtë.

Tabela 18. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për grupin e II-të

Operatori	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Maliq UK	81.77	96.40	14.63
Himarë UK	63.26	75.34	12.08
Krujë U	65.63	72.82	7.19
Skrapar UK	78.96	82.42	3.46
Patos UK	77.15	80.34	3.19
Devoll UK	80.49	82.84	2.35
Tepelenë UK	75.05	75.93	0.88
Pogradec UK	84.80	85.63	0.83
Librazhd UK	97.07	97.65	0.58
Lezhë UK	79.69	79.63	0.06
Mallakastër UK	79.86	78.17	1.69
Gramsh U	84.99	82.61	2.38
Divjakë UK	89.55	86.82	2.73
Përmet UK	89.56	86.48	3.08
Mat UK	82.82	77.53	5.29
Peqin U	77.28	71.42	5.86
Vau i Dejës UK	87.63	81.36	6.27
Gjirokastrë UK	93.83	87.40	6.43
Belsh UK	80.00	72.80	7.20
Kukës UK	69.40	60.09	9.31
Peshkopi UK	68.88	57.32	11.56
Kurbini U	93.40	80.52	12.89
Ura Vajgurore U	87.14	71.99	15.15
Rrogozhinë UK	76.41	58.89	17.52
Selenicë UK	91.41	71.73	19.68
Malësi e Madhe UK	76.77	54.85	21.92

Ecurinë më të mirë e ka UK Maliq me (+14.63%) që e ka çuar këtë shoqëri nga performanca e pranueshme në atë të performancës së mirë, UK Himarë me (+12.08%) si dhe UK Krujë (+7.19%). Në këtë grup janë nëntë shoqëri që kanë përmirësuar treguesin e Normës së Arkëtimit Korente dhe pjesa tjetër 17 shoqëri kanë shënuar regres ku UK Malësi e Madhe ka regresin më të madh me 21.92%, por që ky krahasim nuk është real pasi treguesi për vitin 2016 i korrespondon shoqërisë U Shkodër fshat e cila është shpërbërë duke i kaluar UK Shkodër dhe UK Vau Dejës dhe jo UK Malësisë së Madhe.

Shoqëritë me regres të dukshëm janë dhe UK Selenicë, UK Rrogozhinë, UK Ura Vajgurore, U Kurbin etj

Nga njëra anë shoqëritë kanë bërë përpjekje për arkëtimet e debive të vjetra por kanë çeduar në arkëtimet e vitit korent, ku raportohen 6 shoqëri me rënie dyshifrore të këtij treguesi.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017




Figura 13. Norma e Arkëtimit Korente për grupin e III-të, Viti 2017

Në grupin e tretë ku bëjnë pjesë 11 shoqëri, për dy prej tyre ky tregues është mbi 82% që i përgjigjet performancës së mirë dhe konkretisht UK Kolonjë me 92.43% dhe UK Pukë me 89.27%.

Në nivelin e performancës së pranueshme (60-82%) janë 7 shoqëri që në grafik fillojnë nga U Poliçan me NAK 79.34 % deri te U Këlcyrë me 60.19%. Në brezin e kuq të performancës së dobët janë dy shoqëri U Tropojë me 50.62% dhe UK Fushë Arrëz me 57.72%.

Tabela 19. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për grupin e III-të

Operatori	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Delvinë UK	61.99	72.07	10.09
Has UK	71.06	76.14	5.08
Poliçan U	75.33	79.34	4.01
Bulqizë U	74.75	77.60	2.85
Kolonjë UK	91.06	92.43	1.37
Bashkia Pukë UK	88.21	89.27	1.06
Libohovë UK	65.08	65.11	0.03
Tropojë U	56.35	50.62	5.72
Mirditë UK	77.69	69.38	8.32
Fushë Arrëz U	68.33	57.72	10.61
Këlcyrë U	76.42	60.19	16.22

Në grupin e tretë janë 7 shoqëri që raportojnë përmirësim të treguesit NAK, në krye qëndron UK Delvinë me (+10.09%) e me radhe shoqëritë e tjera sipas tabelës së mësipërme. Ecurinë më të dobët e ka U Këlcyrë me (-16.22%), UK Fushë Arrëz (-10.61%) U Mirditë (-8.32%) dhe U Tropojë me (-5.72%)

Përfundime

Përlllogaritja e këtij treguesi është bërë mbi bazën e informacionit shtesë nga shoqëritë lidhur me arkëtimet korente pasi në AKUK ka një raportim jo të saktë nga ana e shoqërive. Kjo për faktin se pyetësorët nuk janë plotësuar në të njëjtën mënyrë nga të gjitha shoqëritë ku ka një ndërthurje dhe një raportim të pasaktë në arkëtimet e debive të vjetra ku shumë shoqëri përfshijnë në këto debi dhe arkëtimet e vonuara të vitit aktual që në fakt nuk ka si të jetë debi e vjetër.

Norma mesatare e arkëtimit korente për sektorin në fund të vitit 2017 ka shënuar një përmirësim me 0.36% dhe ajo e përgjithshme një përmirësim me 1.73%.

Nga 48 shoqëri të analizuar 12 shoqëri rezultojnë me normë arkëtimi në nivelin e performancës së mirë. Në nivelin e performancës së pranueshme (60%-82%) janë 29 shoqëri dhe në nivelin e performancës së dobët, nën 60%, janë 5 shoqëri.

Ky tregues si sektor është përmirësuar por gjatë analizës individuale është vërejtur se 50% e shoqërive kanë shënuar progres dhe në të njëjtin nivel janë dhe shoqëritë që kanë shënuar regres të treguesit. Kjo tregon se manaxherët e shoqërive me stafet përkatëse duhet të punojnë fort për të bërë përpjekjet e duhura për arkëtimin e faturave për shërbimin UK.

Konstatohet se për shumë shoqëri krahasimi me vitin paraardhës nuk është real pasi shoqëritë janë riorganizuar dhe kanë ndryshuar qoftë në territor por dhe në shërbimin e ofruar, ku ka shoqëri që janë shkrirë dhe i janë bashkangjitur një ose më shumë shoqërive të cilat në shumë raste kanë patur nivele të ulëta arkëtimi gjë që ka ndikuar në përkeqësimin e këtij treguesi në shoqëritë e prekura nga reforma. Gjithsesi për statistikë janë paraqitur si në grafik ashtu dhe në tabelat e ecurisë.

Një efikasitet i mirë në arkëtimin e të ardhurave ka të bëjë me fuqizimin financiar të shoqërisë që ndikon drejtpërdrejt në aftësinë paguese të shoqërisë.

2.3.5 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes është raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje. Ky tregues nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë, pasi analizon vetëm lidhjet me matës të kategorive të konsumatorëve. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "Uji pa të Ardhura".

Ky tregues për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 është rritur me 3.7% duke e çuar në nivelin 68.3% shumë larg objektivit të vendosur nga ERRU dhe Strategjia Kombëtare i cili është 85%. Ecuria ndër vite tregon se mbetet ende shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim në arritjen e këtij treguesi. Ky tregues është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë duke ndikuar në përmirësimin e tyre.

Grupi i parë i shoqërive

Performanca për vitin 2017




Figura 14. Niveli i Matjes për grupin e I-rë, Viti 2017

Për shkak të riorganizimit të shoqërive UK Korçë, e cila për vite me radhë ka qenë shoqëria e vetme me nivel matje 100%, këtë vit ka pësuar rënie me 2.88% me zgjerimin e zonës së shërbimit me disa njësi administrative të ish Ujësjellës Korçë (F) dhe disa njësi administrative që shërbimi kryej nga vet ish komuna. Nga 11 shoqëri të këtij grupi, 9 shoqëri kanë përmirësim të këtij treguesi ndërsa 2 (dy) shoqëri kanë raportuar ulje të % së nivelit të matjes.

Rritje të dukshme të këtij treguesi krahasuar me vitin 2016 kanë raportuar 3 shoqëri UK Berat - Kuçovë (64.86%) me rritje 15.17%, UK Lushnje (88.99%) me rritje 9.45 % si rezultat i investimeve të kryera në këto qytete dhe UK Sarandë (72.61%) me rritje 5.03% për shkak të riorganizimit.

Mbi nivelin e performancës së mirë prej 85 % kanë raportuar 3 shoqëri UK Korçë (93.56 %), UK Durrës (89.69 %) dhe UK Lushnje (88.99 %). Shoqëritë e tjera kanë nivelin e matjes nën kufirin e performancës së mirë.

Ecuria e nivelit të matjes për shoqëritë e grupit të parë paraqitet e detajuar për tre vitet e fundit më poshtë në tabelën 20.

Tabela 20. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e I-rë

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Berat - Kuçovë UK	44.56	49.69	64.86	15.17
Lushnje UK	77.35	79.54	88.89	9.35
Sarandë UK	64.93	67.58	72.61	5.03
Tiranë UK	78.98	77.09	80.27	3.18
Shkodër UK	39.22	51.85	54.49	2.64
Durrës UK	84.50	87.35	89.69	2.34
Kavajë UK	48.42	51.03	53.32	2.29
Vlorë UK	40.74	37.79	39.16	1.37
Elbasan UK	64.29	66.07	66.45	0.38
Korçë UK	100.00	96.44	93.56	2.88
Fier UK	54.79	54.73	47.73	7.00

Gjatë vitit 2017 kanë pësuar përkeqësim të këtij treguesi krahasuar me vitin 2016 dy shoqëri: UK Fier (47.73%) me një rënie të nivelit të matjes me 7 % dhe UK Korça (93.56 %) me rënie të nivelit të matjes me 2.88 % por që përsëri mbetet mbi nivelin e performancës së mirë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017




Figura 15. Niveli i Matjes për grupin e II-të, viti 2017

Grupi i dytë ka 28 shoqëri, 3 (tre) shoqëri më shumë se në vitin e kaluar por për krahasim do të marrim 26 shoqëri pasi UK Cërrik (74.19 %) dhe UK Roskovec (68.15 %) janë shoqëri të reja të krijuara pas reformës administrative dhe kanë raportime vetëm për vitin 2017.

Për vitin 2017 mbi kufirin e performancës së mirë me nivel matje 85 % kanë raportuar 5 (pesë) shoqëri UK Pogradec, UK Devoll, U Divjakë, UK Librazhd, UK Peqin. Nivelin e matjes 100% nuk e ka asnjë shoqëri edhe U Divjakë e cila në 2 vitet e fundit e ka pasur 100% këtë vit ka një rënie me 2.63 % ndërsa U Lushnje Fshat pas reformës administrative nuk ekziston më, aksionet e së cilës janë përthithur nga shoqëritë e tjera.

Në tabelën 21, si më poshtë paraqitet ecuria e këtij treguesi për grupin e dytë sipas tre viteve të fundit.

Tabela 21. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e II-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Vau i Dejës UK	7.46	8.78	46.16	37.38
Gjirokastrë UK	1.00	6.20	29.90	23.70
Rrogozhinë UK	63.27	63.21	76.49	13.28
Mallakastrë UK	30.25	29.38	39.32	9.94
Peshkopi UK	27.96	36.72	45.03	8.31
Gramsh U	43.89	45.61	53.15	7.54
Lezhë UK	64.40	66.46	72.55	6.09
Himarë UK		56.74	62.00	5.26
Belsh UK		74.90	79.46	4.56
Përmet U	65.46	68.08	72.31	4.23
Ura Vajgurore U	65.07	75.52	79.43	3.91
Peqin UK	83.51	81.92	85.50	3.58
Skrapar UK		6.51	9.33	2.82
Patos UK	0.04	19.16	21.80	2.64
Maliq UK	42.32	45.51	47.97	2.46
Tepelenë UK	36.65	61.73	64.18	2.45
Malësi e Madhe U	28.98	33.16	34.57	1.41
Devoll UK	97.76	98.45	99.57	1.12
Pogradec UK	97.99	99.19	99.87	0.68
Librazhd UK	93.97	95.17	95.43	0.26
Selenicë U	1.23	5.52	5.37	0.15
Kurbin U	11.01	13.03	12.17	0.86
Mat UK	46.94	44.59	43.47	1.12
Divjakë U	100.00	100.00	97.37	2.63
Kukës UK	28.18	29.30	25.58	3.72
Krujë UK	85.56	73.67	64.58	9.09

Niveli i matjes për këtë vit në këtë grup ka pasur tendencë rritje pasi nga 26 shoqëri që merren në krahasim, 20 prej tyre kanë pësuar rritje të treguesit. Rritje të ndjeshme në të gjithë grupin ka pësuar UK Vau Dejës me 37.66 % dhe me pas UK Gjirokastrë me 23.70 % duke vijuar më pas me UK Rrogozhinë me 13.28 %, UK Mallakastrë me 9.94 %, UK Peshkopi me 8.31 %, U Gramsh me 7.54 %, UK Lezhë me 6.09 % dhe UK Himarë me 5.26 %.

Përkeqësim të këtij treguesi dhe që vlen për t'u përmendur është UK Krujë me rënie të nivelit të matjes me 9.09 %, si rezultat i përthithjes së UK Fushë Krujë duke e bërë të kalojë nën kufirin e performancës së mirë në të cilën ishte në vitin 2015. Ndërsa 5 shoqëritë e tjera siç vërehet dhe nga tabela kanë pësuar rënie jo të ndjeshme të nivelit të matur nën 3.72 %.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Grupi 3 - Niveli i Matjes (%)




Figura 16. Niveli i Matjes për grupin e III-të, Viti 2017

Grupi i tretë duke qenë grupi i shoqërive të vogla vazhdon të jetë grupi me shërbimin e matur në nivelet më të ulëta. Në këtë grup asnjë shoqëri për këtë tregues nuk kalon nivelin e performancës së mirë prej 85 %. Nga 14 shoqëri të këtij grupi vetëm 11 merren në shqyrtim pasi nga tre shoqëritë UK Vorë, UK Konispol dhe UK Pustec janë shoqëri të reja dhe raportojnë për herë të parë. Madje UK Konispol dhe UK Pustec janë ende në proces licencimi edhe pse kanë raportuar të dhëna për këtë vit.

Mesatarja e këtij grupi për këtë tregues është shumë e ulët, vetëm 3 shoqëri kanë nivelin e matjes mbi 50 %.

Ecuria e Nivelit të Matjes gjatë tre viteve të fundit për këtë grup paraqitet më poshtë në tabelën 22.

Tabela 22. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e III-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Tropojë UK		34.84	72.08	37.24
Këlcyrë U	3.99	26.75	37.08	10.33
Bashkia Pukë UK	44.02	43.02	46.44	3.42
Kolonjë UK	67.61	66.27	68.92	2.65
Has UK	60.73	62.97	63.78	0.81
Delvinë UK	38.62	40.72	41.52	0.80
Libohovë UK		0.26	0.15	0.11
Bulqizë U	10.72	11.62	11.46	0.16
Fushë Arrëz UK	1.49	1.15	0.67	0.48
Mirditë UK	42.81	43.45	40.18	3.27
Poliçan U	56.45	55.48	46.43	9.05

Në këtë grup përmirësim të këtij treguesi kanë 6 shoqëri nga të cilët vetëm dy vlen të përmenden UK Tropojë me rritje 37.24% dhe UK Këlcyrë me rritje 10.33% ndërsa 4 shoqëri të tjera kanë rritje pothuajse të papërfillshme me nën 4 %. U Tropojë është viti i dytë radhazi që raporton rritje të dukshme të këtij treguesi duke çuar nivelin e matjes në 72.08 %.

Shoqëritë të cilat nuk kanë pothuajse fare shërbim të matur janë: UK Fushë - Arrëz me 0.67 % dhe UK Libohovë me 0.15 %.

Rënie më të ndjeshme të nivelit të matjes për vitin 2017 kanë raportuar dy shoqëri U Poliçan me rënie 9.05 % dhe UK Mirditë me 3.27 %, të dyja këto shoqëri kanë marrë zona të reja sipas reformës gjë që ka ndikuar në këtë tregues.

Përfundime

Për të dytin vit radhazi shihet që shoqëritë kanë pësuar luhatje të tregueseve në përgjithësi pasi kanë qenë në proces riorganizimi, kalimit të zonave nga një shoqëri në një tjetër ose përfshirjen e zonave të reja të pambuluara me shërbim më parë nga shoqëritë ekzistuese duke ndikuar ndjeshëm dhe në nivelin e matjes. Të dhënat tregojnë se ende nuk ka përfunduar vendosja e matësve për të gjithë klientët jo familjarë, me gjithë përpjekjet e shoqërive për të përfunduar këtë proces.

Ky tregues për sektorin në përgjithësi për vitin 2017 është rritur me 3.7 % duke e çuar nivelin mesatar në 68.3 % shumë larg objektivit 85 % të Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017.

Shoqëritë UK kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit si një prioritet i vendosur dhe nga qeveria deri në fillim të vitit 2018, por me gjithë përpjekjet dhe ecurinë mbetet shumë punë për të realizuar këtë objektiv.

Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive dhe gjithashtu i krijon mundësi shoqërive të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë.

Në total për të tre grupet janë 9 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë përse i përket shërbimit të matur me mbi 85 % (3 janë në grupin e parë, 5 në grupin e dytë dhe vetëm 1 shoqëri në grupin e tretë). Në grupin e tretë dy shoqëri pothuajse nuk e masin fare këtë shërbim, i cili nuk kalon as 1%, UK Fushë - Arrëz me 0.67 % ndërsa UK Libohovë me 0.15 %.

ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësve plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK si dhe mbështet e nxit të gjitha shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve individual. Në fokus të punës së operatorëve duhet të jetë zbatimi i programeve për instalimin e matësve individual dhe në prodhim për të bërë të mundur eliminimin e praktikës aforfe.

2.3.6 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë manaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK, potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiçencës në punë, dhe në këtë mënyrë të rritjes së efiçencës së përgjithshme të shoqërisë. Duke qenë se kostot e personelit zënë një përqindje të madhe të kostove O&M të shoqërive UK, ky tregues merr rëndësi të veçantë prandaj edhe është përfshirë në listën e treguesve kryesorë të performancës.

Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë, etj, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive. Zhvillimet në sektor, marrja e zonave rurale si dhe zonave që më parë nuk janë shërbyer ka bërë që numri i stafit të rritet ndjeshëm. Nga ana tjetër zgjerimi ka sjell dhe rritje të lidhjeve UK, pra efekti negativ i rritjes së stafit është zëruar nga efekti pozitiv i rritjes së lidhjeve UK.

Niveli mesatar i punonjësve për 1000 lidhje UK për sektorin është 5.51 nga 5.34 që ishte në fund të vitit 2016.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Për grupin e parë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët




Figura 17. Efiçenca e Stafit për grupin e I-rë, Viti 2017

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen dy shoqëri UK Korçë e cila ka edhe performancën më të mirë me 2.23 punonjës për 1000 lidhje dhe UK Tiranë me 3.92 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme janë 5 shoqëri sipas grafikut nga UK Vlorë deri te UK Durrës me 5.33 punonjës /000 lidhje. Në brezin e performancës së dobët janë 4 shoqëri dhe konkretisht UK Lushnje, UK Fier, UK Shkodër dhe UK Kavajë.

Ecuria sipas tre viteve për shoqëritë e grupit të parë paraqitet më poshtë në tabelën 23.

Tabela 23. Ecuria e Efijencës së Stafit për grupin e I-rë

Operatori	2015 (S/000/lidhje)	2016 (S/000/lidhje)	2017 (S/000/lidhje)	Ndryshimi 2017-2016 (S/000/lidhje)
Fier UK	6.37	7.21	6.56	-0.65*
Vlorë UK	3.77	4.98	4.40	-0.58
Elbasan UK	3.58	5.24	4.73	-0.51
Durrës UK	5.50	5.24	5.33	0.09
Korçë UK	2.15	2.06	2.23	0.17
Berat - Kuçovë UK	5.34	4.78	4.96	0.18
Lushnje UK	5.90	5.88	6.52	0.64
Shkodër UK	4.34	5.97	6.70	0.73
Tiranë UK	3.75	3.08	3.92	0.84
Sarandë UK	3.71	4.23	5.15	0.92
Kavajë UK	7.96	6.72	7.97	1.25

***Shenim** : Për këtë tregues Vlerat(-) tregojnë përmirësim të performancës.

Tendencën pozitive më të mirë në grupin e parë e ka pasur UK Fier dhe UK Vlorë, ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur përkatësisht me (0.65) dhe (0.58) punonjës për 1000 lidhje.

Për UK Fier ky përmirësim ka ardhur për faktin se si numri i stafit dhe i lidhjeve kanë pasur tendencë pozitive ku stafi është ulur me 19 punonjës dhe lidhjet UK janë shtuar me 2881 lidhje. Për UK Vlorë dominues në këtë përmirësim ka qenë rritja e numrit të lidhjeve UK me 22847 lidhje pasi numri i punonjësve është rritur me +62 punonjës. Për UK Elbasan përpunimi i të dhënave duke bashkuar dy shoqëritë fshat dhe qytet nuk mund të gjykohej si i saktë dhe nuk e marrim në konsideratë për efekt krahasimi.

Të gjitha shoqëritë e tjera të grupit kanë shënuar përkeqësim të treguesit që varion nga 0.09 për UK Durrës deri në 1.25 për UK Kavajë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Për grupin e dytë, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.




Figura 18. Efienca e Stafit për grupin e II-të, viti 2017

Në nivelin e performancës së mirë bëjnë pjesë UK Lezhë (5.32), UK Pogradec (5.5), UK Devoll (5.53), UK Mat (5.7) si dhe UK Krujë (5.83) punonjës për 1000 lidhje.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 11 shoqëri duke filluar nga UK Himarrë deri te UK Tepelenë që variojnë brenda kufirit prej 6.19 deri 9.59 punonjës për 1000 lidhje. Nëntë nga këto shoqëri në këtë brez performance kanë qenë dhe në vitin 2016, përjashtim kanë bërë U Gramsh dhe UK Skrapar që nga performanca e dobët respektivisht me 10.32 dhe 11.14 punonjës për 1000 lidhje kanë kaluar në brezin e performancës së pranueshme.

Në zonën e kuqe, atë të performancës së dobët (mbi 10 punonjës për 1000 lidhje) renditen 11 shoqëri. Performuesi më i dobët në këtë grup është UK Peqin (23.67) duke vijuar me UK Mallakastër (16.67), UK Roskovec (16.24) si dhe U Malësi e Madhe (15.28) punonjës për 1000 lidhje.

Ecuria e treguesit të efiençës së stafit për grupin e dytë sipas tre viteve të fundit paraqitet më poshtë në tabelën 24.

Tabela 24. Ecuria e Efijencës së Stafit për grupin e II-të

Operatori	2015 (\$/000/lidhje)	2016 (\$/000/lidhje)	2017 (\$/000/lidhje)	Ndryshimi 2017-2016 (\$/000/lidhje)
Patos UK	28.02	19.68	13.12	-6.56
Devoll UK	8.56	9.00	5.53	-3.47
Skrapar UK	17.92	11.14	8.37	-2.77
Gramsh U	10.69	10.32	7.79	-2.53
Kurbin U	22.95	16.29	14.51	-1.78
Vau i Dejës UK	10.17	11.35	10.24	-1.11
Peshkopi UK	6.64	8.05	6.98	-1.07
Malësi e Madhe U	20.83	16.30	15.28	-1.02
Përmet U	11.51	15.26	14.25	-1.01
Pogradec UK	4.00	6.03	5.50	-0.53
Belsh UK		9.56	9.13	-0.43
Himarë UK		6.50	6.19	-0.31
Mat UK	6.08	5.96	5.70	-0.26
Krujë UK	6.44	5.83	5.83	0.00
Librazhd UK	6.40	6.38	6.39	0.01
Kukës UK	8.78	7.94	8.01	0.07
Ura Vajguore U	13.31	13.48	13.86	0.38
Maliq UK	7.94	8.16	8.55	0.39
Selenicë U	8.06	11.84	12.39	0.55
Lezhë UK	4.79	4.52	5.32	0.80
Divjakë U	12.78	12.86	13.89	1.03
Mallakastër UK	16.24	15.55	16.67	1.12
Rrogozhinë UK	5.23	5.95	7.58	1.63
Gjirokastër UK	7.65	7.34	9.17	1.83
Tepelenë UK	8.88	7.41	9.59	2.18
Peqin UK	23.32	20.98	23.67	2.69

Për vitin 2017 për 12 shoqëri të këtij grupi tendenca ka qenë pozitive me përmirësime që variojnë nga 0.31 p/1000/lidhje në 6.56 p/1000/lidhje, përmirësim që i takon UK Patos e cila edhe pse renditet në zonën e kuqe ka patur tendencën pozitive më të madhe në grupin e dytë. Ky përmirësim ka ardhur për faktin e rritjes së numrit të lidhjeve me sistemin e kanalizimeve (+3954 lidhje Kanalizime) si dhe janë shtuar 139 lidhje uji ndërsa numri i punonjësve ka mbetur i pandryshuar. Janë 11 shoqëri që kanë pasur tendencë negative të këtij treguesi ku UK Peqin dhe UK Tepelenë kanë regresin më të madh respektivisht (-2.69) dhe (-2.18) punonjës për 1000 lidhje.

Grupi i III-të i Shoqërive

Për grupin e tretë niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.

Grupi 3 - Efienca e Stafit (staf / 1000 lidhje)




Figura 19. Efienca e Stafit për grupin e III-të, viti 2017

Në grupin e tretë, 3 nga 11 shoqëri kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është UK Kolonjë me (6.11) punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë renditen edhe UK Delvinë me (6.59) punonjës për 1000 lidhje dhe UK Fushë Arrëz me (9.22) punonjës për 1000 lidhje.

Në brezin e performancës së pranueshme, pra në nivelin 10-15 punonjës janë 5 shoqëri. Disa nga këto shoqëri kanë qenë në këtë zonë edhe në vitin 2016 ndërsa UK Bashkia Pukë me 11.61 punonjës për 1000 lidhje ka kaluar nga brezi i performancës së mirë në atë të pranueshme. UK Tropojë e ka përmirësuar këtë tregues në 15 punonjës për 1000 lidhje duke kaluar kështu në brezin e shoqërive me performancë të pranueshme. Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 3 shoqëri. U Has renditet e fundit me (19.31) punonjës për 1000 lidhje duke vazhduar me U Poliçan dhe UK Libohovë.

Tabela 25. Ecuria e Efiençës së Stafit për grupin e III-të

Operatori	2015 (S/000/lidhje)	2016 (S/000/lidhje)	2017 (S/000/lidhje)	Ndryshimi 2017-2016 (S/000/lidhje)
Poliçan U	30.50	28.96	16.86	-12.10
Tropojë U	18.72	16.41	15.06	-1.35
Has U	25.46	20.61	19.31	-1.30
Delvinë UK	6.66	7.26	6.59	-0.67
Mirditë UK	16.83	12.49	11.94	-0.55
Bulqizë U	13.38	13.50	13.27	-0.23
Kelçyrë U	13.97	13.77	14.25	0.48
Fushë Arrëz U	8.60	8.64	9.22	0.58
Kolonjë UK	7.08	5.41	6.11	0.70
Bashkia Pukë UK	9.50	9.43	11.61	2.18
Libohovë UK	10.22	12.76	15.44	2.68

Ndryshim pozitiv të ndjeshëm kanë patur U Poliçan, (-12.1) për faktin se pas riorganizimit të shoqërisë janë shtuar 1000 lidhje të reja të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe ulje të stafit me dy punonjës. Përmirësim ka shënuar dhe U Tropojë si dhe U Has. Tendencën negative më të madhe e ka UK Libohovë (+2.68) e cila renditet në fund të tabelës si dhe UK Bashkia Pukë (2.18) punonjës për 1000 lidhje.

Përfundime

Në vitin 2017, treguesi staf për 1000 lidhje është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës për faktin se si numri i punonjësve dhe numri i lidhjeve UK kanë pësuar rritje. Rritja që kanë pësuar dy variablat e këtij treguesi justifikohen në pjesën më të madhe të tyre nga zhvillimet në sektor riorganizimi i shoqërive, nevojat për staf për shkak të shtrirjes së shërbimit të cilat i kemi vënë në dukje dhe në pjesën e parë të raportit.

Në kuadër të objektivit të përgjithshëm strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare përmes përmirësimeve në mbulimin e kostove, rritja e numrit të punonjësve dhe nivelet e ulëta të produktivitetit të punonjësve mbeten një shqetësim serioz për ERRU-në. Punësimet artificiale kanë një ndikim të madh në performancën e shoqërisë. Përmirësimi i treguesit të efikasitetit të stafit ndikon direkt në reduktimin e kostove të punës.

Çelësi i suksesit për arritjen e objektivave të performancës lidhur me këtë tregues qëndron në optimizimin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të dedikuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësi si dhe zgjerimin e bazës së klientëve.

Për të nxitur shoqëritë që të rrisin efikasitetin e stafit të tyre, ERRU vendos objektiva individuale për secilën nga shoqëritë ujësjellës kanalizime në procesin e ndryshimit të tarifave.

2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së shërbimit të një shoqërie është kohëzgjatja e furnizimit me ujë e cila është mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët. Ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, kërkon vëmendjen nga shoqëritë UK dhe duhet të mbetet prioritet, pasi përmirësimi i këtij treguesi redukton nevojën për gjetjen e burimeve të tjera më të kushtueshme për konsumatorët.

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë lidhet me aftësinë e shoqërisë për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi në mënyrë që t'u japë konsumatorëve të saj shërbimin në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbi konsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete.

Konsumatori e kompenson këtë mungesë të "vazhdimësisë së shërbimit" me anë të blerjes së ujit dhe të instalimit të pompave dhe të depozitave të ujit që mbushen kur sistemi i shpërndarjes është me presion.

Për vitin 2017 ky tregues është 12 orë/ditë dhe nuk ka patur asnjë përmirësim përkundrazi ka pësuar rënie me 0.3 orë/ditë më pak nga 12.3 orë/ditë që ka qenë në vitin 2016. Duket qartë që ky tregues është shumë larg arritjes së objektivit të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare ku ky tregues për vitin 2017 duhej të ishte 20 orë/ditë dhe objektivit të performancës së mirë të vendosur nga ERRU i cili duhet të ishte 18

orë/ditë. Mendojmë, se kjo rënie e këtij treguesi për këtë vit ka ardhur edhe si rezultat i përfundimit të riorganizimit të pjesës më të madhe të shoqërive UK duke krijuar vështirësi në manaxhimin e sistemeve të reja aty ku ka pasur sisteme ose marrja e zonave të reja që nuk kanë pasur fare sisteme të trashëguara nga njësitë administrative.

Këtë vit vetëm 1 (një) shoqëri UK Librazhd e ofron shërbimin e furnizimit me ujë 24 orë/ditë nga 5 (pesë) shoqëri UK Korçë, Devoll, Rubik dhe Bashkia Pukë, të cilat ofronin ujë 24 orë/ditë me presion në të gjithë sistemet e tyre gjatë vitit 2016. Ky reduktim i shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë 24 orë/ditë është i justifikuar pasi këto shoqëri kanë përfunduar riorganizimin duke çuar në ndryshim të zonës së tyre të shërbimit ndërsa UK Rubik nuk ekziston më se është bashkuar me UK Mirditë.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2017

Grupi 1 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 20. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e I-rë, Viti 2017

Në grupin e parë të shoqërive, nga analiza e bërë gjatë vitit 2017 shihet që ka pasur luhatje shumë të vogla të këtij treguesi.

Përmirësim të këtij treguesi me 4.2 orë/ditë dhe për këtë vit ka pësuar UK Sarandë si pasojë e shpërndarjes së disa zonave sipas riorganizimit, e cila për vitin 2017 e ka raportuar furnizimin me ujë 12.2 orë/ditë krahasuar me vitin 2016 që ka qenë 8 orë/ditë duke kaluar mbi kufirin e performancës së dobët, e cila është 8 orë/ditë por përsëri larg arritjes së performancës së mirë e cila është 18 orë/ditë.

Shoqëria e dytë që ka rritje të këtij treguesi me 1.86 orë/ditë për vitin 2017 është UK Lushnje e cila ka raportuar furnizimin me ujë 6.86 orë/ditë krahasuar me vitin 2016 që ka qenë 5 orë/ditë, por dhe pas këtij përmirësimi mbetet përsëri nën kufirin e performancës së dobët prej 8 orë/ditë. Kjo rritje ka ardhur nga bashkimi me ish ujësjellësin Lushnje fshat si dhe investimeve që po kryen KfW në këtë qytet.

Shoqëria UK Durrës, megjithëse është ndër shoqëritë më të mëdha të grupit të parë, për të dytin vit radhazi renditet e fundit me 3.01 orë/ditë nga 3.56 orë/ditë furnizim me ujë që ishte për vitin 2016.

Në këtë grup janë 3 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë me mbi 18 orë ujë në ditë dhe është i njëjtë me vitin 2016, si UK Korçë, e cila ka një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2016 nga 24 orë/ ditë në 23.72 orë/ ditë kjo si shkak i zgjerimit të zonës së shërbimit, UK Shkodër e cila ka një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2016 nga 21.39 orë ujë në ditë në 20.14 orë ujë në ditë dhe UK Fier e cila gjithashtu ka një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2016 nga 20.96 orë ujë në ditë në 19.49 orë ujë në ditë.

Ecuria e këtij treguesi për grupin e parë të shoqërive për tre vitet e fundit paraqitet si më poshtë në tabelën 26.

Tabela 26. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e I-rë

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Sarandë UK	5.69	8.00	12.20	4.20
Lushnje UK	4.70	5.00	6.86	1.86
Kavajë UK	9.22	9.24	9.29	0.05
Elbasan UK	11.85	11.84	11.58	0.26
Korçë UK	24.00	24.00	23.72	0.28
Durrës UK	7.37	3.56	3.01	0.55
Tiranë UK	10.92	10.83	10.20	0.63
Vlorë UK	12.82	11.97	11.10	0.87
Shkodër UK	21.62	21.39	20.14	1.25
Fier UK	20.26	20.96	19.49	1.47
Berat - Kuçovë UK	9.67	8.88	7.36	1.52

Rënie më të dukshme të këtij treguesi krahasuar me vitin 2016 me mbi 1 orë /ditë kanë: UK Berat - Kuçovë me rënie të furnizimit me ujë me 1.52 orë /ditë për arsyen se kjo shoqëri gjatë vitit 2017 ka qenë në fazë rikonstruksioni të rrjetit të brendshëm si dhe ka pësuar ndryshim të zonës së shërbimit duke ju larguar zona e Bogovës një zonë me furnizim me ujë 24 orë/ditë, UK Fier me rënie të furnizimit me ujë me 1.47 orë /ditë dhe UK Shkodër me rënie të furnizimit me ujë me 1.25 orë /ditë.

Gjatë këtij viti asnjë nga shoqëritë e këtij grupi nuk ofron shërbim të furnizimit me ujë të pandërprerë prej 24 orë/ditë.

Për shoqëritë e grupit të parë të cilat mbulojnë me shërbim një pjesë të konsiderueshme të popullsisë në vend duhet të kenë prioritet realizimin e një prej detyrave kryesore përmirësimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë.

Duke krahasuar të dhënat e raportuara në vitin 2017 me raportimet e vitit 2016 shihet që ky grup ka performuar jo mirë në kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, pasi nga 11 (njëmbëdhjetë) shoqëritë e këtij grupi vetëm 2 (dy) shoqëri kanë pësuar përmirësim të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, 9 (nëntë) të tjerat kanë pësuar rënie.

Performanca për vitin 2017

Grupi 2 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 21. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e II-të, Viti 2017

Edhe për këtë vit shoqëria UK Librazhd vazhdon të jetë shoqëria më e mirë për këtë grup me furnizim me ujë për konsumatorët 24 orë/ditë, ndërsa Devolli e cila ka qenë me 24 orë/ditë furnizim me ujë për konsumatorët për dy vitet e fundit, gjatë vitit 2017 ka një rënie me 1.21 orë /ditë më pak duke e çuar furnizimin me ujë në 22.79 orë/ditë.

Mbi kufirin e performancës së mirë me furnizim me ujë mbi 18 orë/ditë për grupin e dytë janë 6 shoqëri, UK Librazhd 24 orë/ditë, UK Pogradec 23.82 orë/ditë, UK Devoll 22.79 orë/ditë, UK Tepelenë 21.70 orë/ditë, U Gramsh 21.25 orë/ditë dhe UK Lezhë 20.66 orë/ditë. Ndërsa UK Mat për vitin 2017 ka rënie të furnizimit me ujë me 5.77 orë/ditë duke e çuar renditjen e kësaj shoqërie nën kufirin e performancës së mirë me furnizimit me ujë 17.16 orë/ditë nga 22.93 orë/ditë që ka qenë në vitin 2016, por që sërish mbetet në kufijtë e kënaqshëm.

Gjithashtu, këtë vit kanë raportuar dhe dy shoqëri të reja të licencuara gjatë këtij viti nga ERRU, të cilat janë krijuar në zbatim të reformës territoriale si UK Cërrik me kohëzgjatje të furnizimit me ujë 14.60 orë/ditë si dhe UK Roskovec me 3.99 orë/ditë furnizim me ujë.

Ecuria e shoqërive në grupin e dytë për tre vitet e fundit pasqyrohet si më poshtë në tabelën 27.

Tabela 27. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e II-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Gjirokastrë UK	3.68	3.44	12.60	9.16
Krujë UK	3.81	4.56	8.92	4.36
Peshkopi UK	7.75	7.83	10.52	2.69
Peqin UK	9.40	11.56	13.94	2.38
Patos UK	3.00	7.08	8.67	1.59
Vau i Dejës UK	10.55	8.72	9.97	1.25
Gramsh U	19.86	20.19	21.25	1.06
Ura Vajgurore U	5.32	5.59	6.29	0.70
Lezhë UK	19.75	20.14	20.66	0.52
Skrapar UK	6.00	7.08	7.51	0.43
Pogradec UK	21.43	23.72	23.82	0.10
Himarë UK		15.08	15.16	0.08
Librazhd UK	24.00	24.00	24.00	0.00
Selenicë U	10.82	5.36	4.99	0.37
Maliq UK	12.81	14.68	14.25	0.43
Tepelenë UK	16.49	22.44	21.70	0.74
Kurbin U	4.68	4.84	4.00	0.84
Divjakë U	4.85	4.82	3.90	0.92
Devoll UK	24.00	24.00	22.79	1.21
Rrogozhinë UK	11.00	10.85	9.46	1.39
Malësi e Madhe U	11.15	13.15	11.59	1.56
Belsh UK		11.18	9.41	1.77
Kukës UK	9.33	10.83	8.70	2.13
Përmet U	16.54	15.81	12.32	3.49
Mallakastër UK	13.12	13.37	9.43	3.94
Mat UK	11.75	22.93	17.16	5.77

Në këtë grup shihet që 12 shoqëri kanë raportuar rritje të këtij treguesi nga 0.08 në 9.16 orë ujë në ditë. Përmirësimin më të mirë të këtij treguesi krahasuar me vitin 2016 për këtë grup e ka patur UK Gjirokastrë me 9.16 orë/ditë si rezultat i përfundimit të fazës së parë të projektit për rikonstruksionin e rrjetit të brendshëm të qytetit, e cila më pas pasohet nga shoqëri të tjera që këtë përmirësim e kanë pasur nën 5 orë/ditë furnizim me ujë: si UK Krujë me 4.36 orë/ditë, UK Peshkopi me 2.69 orë/ditë, UK Peqin me 2.38 orë/ditë, UK Patos me 1.59 orë/ditë, UK Vau-Dejës me 1.25 orë/ditë dhe U Gramsh me 1.06 orë/ditë.

Rënie të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë nga -0.37 orë/ditë deri në -5.77 orë/ditë për grupin e dytë kanë raportuar 13 shoqëri. Rënie të dukshme të këtij treguesi në më shumë se 1 orë/ditë kanë raportuar 8 shoqëri si: UK Mat me -5.77 orë/ditë, UK Mallakastër me -3.94 orë/ditë, U Përmet me -3.49 orë/ditë, UK Kukës me -2.13 orë/ditë, UK Belsh me -1.77 orë/ditë, U Malësi e Madhe me -1.56 orë/ditë, UK Rrogozhinë me -1.39 orë/ditë dhe UK Devoll me -1.21 orë/ditë.

Nën kufirin e performancës së dobët nën nivelin e furnizimit me ujë deri në 8 orë/ditë janë 6 shoqëri. Ndërmjet kufirit të dobët dhe kufirit të mirë me 8 deri në 18 orë/ditë furnizim me ujë janë 16 shoqëri.

Grupi 3 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 22. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e III-të, Viti 2017

Numri i shoqërive të grupit të tretë është zvogëluar për vitin 2017 në 12 shoqëri nga 21 që kanë qenë në vitin 2016. Kjo pasi 3 shoqëri si UK Vau Dejës, UK Skrapar dhe U Divjakë kanë kaluar në grupin e dytë, ndërsa 7 shoqëri janë bashkuar me operatorë të tjerë sipas reformës administrative. Këtë vit është shtuar UK Vorë, e cila ka raportuar të dhënat për herë të parë por që nuk ka bazë krahasimi me vitin e kaluar.

Për këtë vit mesatarja e këtij grupi ka një rritje të furnizimit me ujë me 0.8 orë/ditë duke e çuar në 11.3 orë/ditë nga 10.5 orë/ditë që ka qenë në vitin 2016. Gjatë vitit 2017 në këtë grup nuk ka asnjë shoqëri që të ofrojë furnizim me ujë në nivelin e performancës së mirë prej 24 orë/ditë për këtë vit. UK Bashkia Pukë e cila për vitin 2016 ka raportuar furnizim me ujë 23.9 orë/ditë, për vitin 2017 ka një rënie me 6.01 orë/ditë duke e çuar këtë tregues nën nivelin e performancës së mirë me 17.89 orë/ditë.

Në kufijtë e performancës së mirë me kohëzgjatje të furnizimit me ujë nga 8 orë/ditë në 18 orë/ditë janë 8 shoqëri ndërsa nën kufirin e furnizimit me ujë 8 orë/ditë janë 4 shoqëri.

Në tabelën 28 të mëposhtme është paraqitur ecuria e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për grupin e tretë të shoqërive për tre vitet e fundit.

Tabela 28. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e III-të

Operatori	2015 (%)	2016 (%)	2017 (%)	Ndryshimi 2017-2016 (%)
Libohovë UK	6.06	7.97	15.30	7.33
Poliçan U	12.47	11.73	15.98	4.25
Fushë Arrëz UK	12.00	14.33	16.00	1.67
Mirditë UK	13.67	15.50	16.14	0.64
Has U	7.44	7.42	7.52	0.10
Delvinë UK	11.66	7.84	7.58	0.26
Këlcyrë U	7.00	6.04	5.68	0.36
Bulqizë U	6.28	7.40	6.95	0.45
Tropojë U	8.74	12.56	9.74	2.82
Bashkia Pukë UK	20.00	23.90	17.89	6.01
Kolonjë UK	17.46	15.98	8.77	7.21

Për shoqëritë e këtij grupi përmirësim të dukshëm të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë krahasuar me vitin 2016 kanë patur 2 shoqëri përkatësisht UK Libohovë me 7.33 orë/ditë dhe U Poliçan me 4.25 orë/ditë e cila në kuadër të VKM nr. 63, ka marrë njësinë administrative Bogovë, e cila ka furnizim me ujë 24 orë/ditë dhe ka shtuar numrin e matësave duke e përmirësuar mesataren e këtij treguesi.

